



Kolegji Universitar "Bedër"

RAPORTI I VLERËSIMIT TË BRENDSHËM

**Programi i studimit me karakter profesional
"Multimedia dhe Dizajn Grafik"**

Grupi i Vlerësimit të Brendshëm:

1. Dr. Valmora Gogo (kryetar);
2. Msc. Alban Tufa (anëtar);
3. Msc. Rudi Dunga (anëtar);
4. Msc. Norga Sulo (anëtar);
5. Enxhi Gjoni (përfaqësues studentësh).

Janar 2021

Page 1

Tabela e përmbajtjes

A. PËRMBLEDHJE E TE DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË BRENDSHËM.....	3
B. PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË BRENDSHËM	4
VLERËSIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL NË “MULTIMEDIA DHE DIZAJN GRAFIK”	5
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL	5
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL	10
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT	15
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT DHE MBËSHTETJA E STUDENTËVE.....	27
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE.....	36
C. PËRFUNDIME TË VLERËSIMIT TË PROGRAMIT TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL “MULTIMEDIA DHE DIZAJN GRAFIK” TË INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË “KOLEGJI UNIVERISTAR BEDËR”	44



A. PËRMBLEDHJE E TE DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË BRENDSHËM

Rreth programit


Programi profesional në “Multimedia dhe Dizajn Grafik” është hapur nga Ministria Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MAS) me urdhër nr. 211, datë 3.7.2020. Ky program zgjat 2 (dy) vite akademike, i ndarë në 4 (katër) semestra me nga 16 javë secili, përfshirë këtu edhe javët e provimeve. Programi përbëhet nga 120 kredite ECTS, ku për çdo vit parashikohen 60 ECTS, të ndara në 30 ECTS për çdo semestër. Programi profesional në “Multimedia dhe Dizajn Grafik” është projektuar t’u ofrojë studentëve një edukim profesional e të gjithanshëm, si dhe përgatitje teorike e praktike, duke parashtruar një shumëllojshmëri konceptuale dhe perspektive në fushën e medias dhe komunikimit multimedial, dizajnit grafik dhe formave të reja të përcjelljes së informacionit.

Përmes një kurrikule të bazuar dhe të mbështetur në traditën e disa universiteteve me zë në këtë fushë, programi profesional në “Multimedia dhe Dizajn Grafik” synon të zhvillojë një botëkuptim të gjerë të teorive dhe praktikës në fushën e komunikimit, me fokus në produktet multimediale dhe komunikimin nëpërmjet shumë platformave.

Rezultatet e programit

Në përfundim të programit profesional në “Multimedia dhe Dizajn Grafik”, studentët do të jenë në gjendje:

- Të njohin konceptet themelore me të cilat operohet në fushën e multimedias dhe të dizajnit grafik,
- Të zbatojnë, aplikojnë dhe adaptojnë njohuritë teorike dhe praktike të marra rreth fushës së multimedias dhe dizajnit grafik,
- Të regjistrojnë, vizatojnë, rikthejnë dhe rregullojnë përmbajtje të ndryshme që kanë të bëjnë më produkte multimediale, për platformat multimediale,
- Të krahasojnë, analizojnë, klasifikojnë dhe diferencojnë, llojet e produkteve multimediale, cilësinë dhe formatet e produkteve multimediale të gjindshme në media dhe platforma të ndryshme,
- Të përshkruajnë, listojnë, emërojnë dhe shtojnë mjetet dhe nevojat e domosdoshme për të realizuar një punë audio-vizuale,
- Të ndërtojnë dhe vizualizojnë idetë e tyre me softuerët, aplikacionet dhe sistemet multimediale, si dhe të zhvillojnë, riprodhojnë tekstet multimediale,
- Të modifikojnë produktet multimediale të tilla, si foto, video, animacione, postera, audio, dhe produkte transmediale,
- Të eksplorojnë metoda të ndryshme të prodhimit të produkteve mediatike, duke i gërshtuar me mënyrat aktuale të punës,
- Të skicojnë dhe të përkthejnë në projekte punët e kërkuara në mënyrë kreative dhe korrekte, sipas nevojave të klientëve,
- Të përfundojnë punët e tyre në kohën e kërkuar, duke ruajtur raportet mes cilësisë, kohës dhe kërkesave të tregut,
- Të demonstrojnë aftësi të qëndrueshme komunikimi në shkrim, prezantim dhe në të gjithë procesin e punës, nga konceptimi deri në finalizim.



B. PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË BRENDSHËM

Në mbështetje të nenit 103 dhe 104 të ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Statutit të Kolegjit Universitar “Bedër” të përditësuar, si dhe urdhrat të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr.126, datë 17.3.2011 “Për miratimin e standardeve shtetërore të cilësisë për vlerësimin dhe akreditimin institucional të institucioneve të arsimit të lartë”, nën përgjegjësinë e titullarit të njësisë dhe me vendim të Senatit Akademik, u ngrit Grupi i Vlerësimit të Brendshëm (GVB) për programin profesional në “Multimedia dhe Dizajn Grafik”.

Në përzgjedhjen e anëtarëve të GVB-së janë marrë parasysh kompetencat profesionale, paanshmëria, mundësitë për grumbullimin e informacionit për të kryer vlerësimin dhe shkallën e nevojshme të njohjes të anëtarëve të grupit. Grupi është ngritur qëllimisht për misionin e vlerësimit të brendshëm (grup ad-hoc). GVB-ja ka në përbërjen e tij 5 anëtarë sipas një strukturë organizative (drejtuesi, sekretari etj.). Ai përfshin edhe përfaqësues të studentëve, si dhe është ngritur duke marrë parasysh edhe shpërndarjen e detyrave të secilit anëtar.

Ky proces akreditimi për programin e studimit “Programi Profesional në Multimedia dhe Dizajn Grafik” zhvillohet për herë të parë.

Projekti i raportit të vetëvlerësimit u diskutua në njësi, nga ku dolën mendime dhe sugjerime, të cilat plotësuan hartimin e raportit përfundimtar.

ETAPAT E PROCEDURËS SË VLERËSIMIT TË BRENDSHËM

1. Kërkesë për fillimin e procesit të vlerësimit të jashtëm të programit nga ana e Kolegjit Universitar “Bedër” drejtuar Bordit të Akreditimit me shkresë nr. 128, datë 28.05.2020.¹
2. Pranimi i kërkesës dhe njoftimi për trajnimin e grupit të punës mbi sistemin e menaxhimit të ASCAL.
3. Ngritja e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm (GVB) me propozim të këshillit të departamentit dhe miratim të Senatit Akademik, me vendimin nr.1, datë 10.01.2022.
4. Kryerja e vlerësimit të brendshëm, sipas udhëzimeve përkatëse të ASCAL-it.
5. Përgatitja e dosjes së vetëvlerësimit.
6. Hartimi i Raportit të Vlerësimit të Brendshëm (RVB), sipas kërkesave e udhëzimeve në këtë udhëzues dhe pas konsultimit të përmbajtjes së tij me personelin e institucionit.
7. Dorëzimi në ASCAL i Raportit të Vlerësimit të Brendshëm, bashkë me të gjithë dokumentacionin mbështetës.

Shënim: Grupi i Vlerësimit të Brendshëm ngrihet nën përgjegjësinë e titullarit të njësisë, pasi ky i fundit merr mendimin e organit vendimmarrës përkatës. Në përzgjedhjen e anëtarëve të GVB duhen pasur parasysh kompetencat profesionale, paanshmëria, mundësitë për grumbullimin e informacionit për të kryer vlerësimin dhe shkallën e nevojshme të njohjes të anëtarëve të grupit, përfaqësimin në grup të sa më shumë opinioneve të njësisë duke evituar në maksimum përfshirjen në të personave konfliktuale ose koniukturale. Grupi, si rregull, ka në përbërje të tij 3-5 punonjës të njësisë. Ai ngrihet qëllimisht për misionin e vlerësimit (ad-hoc). Ai përcakton një strukturë organizative (drejtuesi, sekretari etj.) dhe një shpërndarje të detyrave. Është e domosdoshme që në GVB të përfshihen dhe përfaqësues të studentëve.

¹ Evidenca: Kërkesë për fillimin e procesit të vlerësimit të jashtëm të programit nga ana e Kolegjit Universitar “Bedër” drejtuar Bordit të akreditimit

VLERËSIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL NË “MULTIMEDIA DHE DIZAJN GRAFIK”

I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PRORAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi me karakter profesional në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij dhe në përputhje me nevojat e kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Programi profesional 2-vjeçar në “Multimedia dhe Dizajn Grafik” është hartuar në përputhje me objektivat e zhvillimit të Kolegjit Universitar “Bedër”, të përcaktuara qartë në planin strategjik 2018-2023. Në planin strategjik 2018-2023 thuhet shprehimisht se “Kolegji Universitar “Bedër” ka si qëllim të sigurojë një arsim cilësor, i cili bëhet garanci për studentët e diplomuar që ndihen të aftë brenda mundësive që ofron tregu i punës. Kolegji Universitar “Bedër” ofron programe studimi në fushën e shkencave humane, sociale, ekonomike, shkencave kompjuterike dhe teknologjisë së informacionit, duke sjellë një profil të qartë në tregun e arsimit të lartë shqiptar dhe atë ndërkombëtar.
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit duhet të përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe të demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Dokumentet kryesorë ku bazohet funksionimi KU “Bedër”, si Statuti, rregullorja themelore dhe rregullorja e organizimit akademik, përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike. ² Programet e studimit të ofruara nga KU “Bedër”, përfshi këtu edhe programin profesional 2-vjeçar në “Multimedia dhe Dizajn Grafik” janë në përputhje me prioritetet akademike të parashikuara në dokumentet e sipërpërmendura. Qëllimi i programeve profesionale është pajisja e studentëve me njohuri teorike dhe praktike në fushat respektive me anë të studimeve dhe praktikës në këto fusha. Në përfundim të programeve të studimit, studentët fitojnë njohuri të përgjithshme dhe të nevojshme në fushat përkatëse. ³
Kriteri 3. Programet e studimeve ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit, si dhe fushën akademike të njësisë kryesore/kolegjit profesional dhe atë të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit.	KU “Bedër” ofron programin profesional në “Multimedia dhe Dizajn Grafik”, që është pjesë e Departamentit të Shkencave të Komunikimit. Departamenti funksionon si njësi bazë e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë. Ashtu siç është parashikuar dhe në rregulloren themelore të KU “Bedër”, programi profesional 2-vjeçar në “Multimedia dhe Dizajn Grafik” funksionon në përputhje të plotë me Procesin e Bolonjës dhe kërkesat e ligjit “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”. Programi ka të përshkruara qartë objektivat dhe kompetencat profesionale ⁴ .
Kriteri 4. Propozimi, hartimi dhe realizimi i	Vendimmarrja për hapjen e këtij programi studimi u bazua pikërisht

² Evidenca 2: Statuti i Kolegjit Universitar “Bedër”, neni 4

³ Evidenca 3: Rregullorja themelore e Kolegjit Universitar “Bedër”, neni 52

⁴ Evidenca 44: Struktura organizative e fakultetit

programit të studimit me karakter profesional mbështetet në studime të mirëfillta mbi tregun lokal e kombëtar të punësimit për këto programe.	në të dhënat e këtij studimi i cili mori në analizë peizazhin e fushës së komunikimit dhe medias në Shqipëri. ⁵ Studimi në fjalë tregoi se fusha e marrëdhënieve publike dhe marketingut janë fusha të reja në tregun shqiptar, të ofruara nga pak universitete vendase. Specialistët e punësuar në zyrat e marrëdhënieve publike dhe marketingut etj., në pjesën dërmuese të tyre vijnë nga programet e studimit në fushën e gazetarisë. Kjo evidenton faktin se në tregu ka nevojë për profesionistë të përgatitur nga programe studimi të posaçme, që pajisin studentët me njohuri dhe kompetenca dhe aftësi profesionale në fushën e komunikimit strategjik apo komunikimit të integruar.			
Kriteri 5. Gjatë realizimit të programit të studimit, nga pranimi në diplomim dhe pas daljes së studentëve në punë, zhvillohen studime periodike mbi tregun e punës, ndryshimet përkatëse dhe punësimin e studentëve.	Departamenti i Shkencave të Komunikimit herë pas here ka kryer studime të thelluara të tregut të punës për të parë nevojat dhe kërkesat e tregut për specialistë të fushës së komunikimit. Një studim është kryer në periudhën nëntor-dhjetor 2019 ⁶ mbi situatën e medias dhe komunikimit në Shqipëri, i cili u realizua me synimin për të pasur evidenca sa më afër reales, në lidhje me tregun e punës për studentët e programeve ekzistuese pranë Departamentit të Shkencave të Komunikimit si dhe çeljen e programeve të reja për t'ju përgjigjur kërkesave të tregut të punës. Është akreditimi i parë i programit dhe nuk ka ende të diplomuar në tregun e punës.			
Kriteri 6. Studimet paraprake dhe periodike të tregut të punës për programet me karakter profesional duhet të përfshijnë të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.	Departamenti i Shkencave të Komunikimit herë pas here ka kryer studime të thelluara të tregut të punës për të parë nevojat dhe kërkesat e tregut për specialistë të fushës së komunikimit. Vendimmarrja për hapjen e këtij programi studimi u bazua pikërisht në të dhënat e një studimi të kryer në periudhën nëntor-dhjetor 2019, ku të dhënat e këtij studimi treguan se fusha e multimedias dhe dizajnit grafik janë fusha të reja në tregun shqiptar, të ofruara nga pak universitete vendase. Specialistët e punësuar në këtë sektor, në pjesën dërmuese të tyre vijnë nga programet e studimit në fusha të tjera. Studimi u realizua me synimin për të pasur evidenca sa më afër reales në lidhje me tregun e punës për studentët e programeve ekzistuese pranë Departamentit të Shkencave të Komunikimit, si dhe çeljen e programeve të reja për t'ju përgjigjur kërkesave të tregut të punës. Si rezultat i këtij studimi tregu, departamenti propozoi çeljen e programit profesional 2-vjeçar “Multimedia dhe Dizajn Grafik”, i cili është tani operacional në semestrin e tretë të tij.			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi I.2	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit dhe me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, dhe në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së	Departamenti i Shkencave të Komunikimit ndjek një praktikë të vazhdueshme bashkëpunimi me njësitë akademike dhe administrative, për të siguruar mbarëvajtjen e punës në drejtim të zbatimit të programit profesional 2-vjeçar në “Multimedia dhe Dizajn Grafik”.

⁵Evidenca 45: Studim tregu i zhvilluar nga Departamenti i Shkencave të Komunikimit mbi “Peisazhin e fushës së medias dhe komunikimit në Shqipëri”

⁶Evidenca 46: Studim Tregu përpara hapjes së programit profesional Multimedia dhe Dizajn Grafik

detyrave mes njësisve e personelit, marrjes së përgjegjësisve respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Në fillim të çdo viti akademik, realizohet ndarja e detyrave dhe koordinimi mes personelit akademik të departamentit, duke përcaktuar qartë përgjegjësitë në këshillimin akademik, realizimin e koordinimit me njësitë dhe zyrat administrative dhe mbikëqyrjen e aktiviteteve shkencore dhe ekstrakurrikulare. ⁷ Në këtë mënyrë këshilli i departamentit përcakton këshilltarët akademikë për çdo grup studentësh, përfaqësuesin e departamentit në zyrën e këshillimit të karrierës dhe zyrën e marrëdhënieve ndërkombëtare. ⁸
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave të procesit mësimor, formimin teorik e praktik të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie afatgjata e të qëndrueshme bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, me punëdhënës vendës, aktorë të biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Në funksion të realizimit të objektivave të programeve studimore, Kolegji Universitar “Bedër” ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe jashtë vendit, si dhe me aktorët e biznesit vendas ose të huaj. KU “Bedër” ndjek një politikë favorizuese për lëvizshmërinë e personelit akademik dhe të studentëve me institucionet arsimore të huaja që ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi për organizimin e përbashkët të konferencave ndërkombëtare dhe projekteve të përbashkëta kërkimore dhe për trajnime profesionale për studentët. Më konkretisht në këtë drejtim janë lidhur marrëveshje bashkëpunimi me universitete në disa vende të Europës, si Rumania, Kroaci etj., që mundësojnë përfshirjen e studentëve në programe shkëmbimi. ⁹ Njëkohësisht në kuadër të kësaj fryme bashkëpunimi, është mundësuar firmosja e memorandumeve të bashkëpunimit me kompani të ndryshme që operojnë në fushën e multimedias dhe dizajnit grafik ¹⁰ .
Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.	Departamenti i Shkencave të Komunikimit harton raportin vjetor të aktiviteteve, të cilin e dorëzon në njësinë kryesore. Pjesë e këtij raporti vjetor është dhe analiza vjetore e punës akademike, kërkimore dhe bashkëpunimi me aktorët e jashtëm, në kuadër të procesit mësimor dhe formues. Raporti vjetor përmban gjithashtu edhe një analizë të detajuar në formatin SWOT, e cila realizohet përmes një punë bashkëpunuese të personelit akademik, duke synuar për të identifikuar pikat e forta, elementet që duhen përmirësuar, mundësitë dhe risqet, me të cilat përballet departamenti në çdo vit akademik. ¹¹
Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.	KU Bedër, veçanërisht Departamenti i Shkencave të Komunikimit u kushton rëndësi të veçantë praktikave profesionale, sipas programeve përkatëse. Prandaj, gjatë verës dhe gjatë vitit akademik, studentët nxiten dhe u ofrohet mundësia të ndjekin praktikat profesionale pranë institucioneve, organizatave dhe bizneseve të ndryshme me të cilat departamenti dhe institucioni ka marrëveshje të ndryshme bashkëpunimi. ^{12 13}
Kriteri 5. Institucioni ndërmerr iniciativa specifike në mbështetje të sipërmarrjes dhe punësimit të studentëve.	KU Bedër duke u bazuar në nevojat e tregut në vend, rajon dhe më gjerë, nxit frymën e formimit të vazhdueshëm dhe trajnimet profesionale. Në këtë kuadër, zyrat përkatëse dhe departamentet ofrojnë një varg metodash dhe modulesh që synojnë zhvillimin e mëtejshëm individual dhe mosshkëputjen nga mjedisi arsimor. Përsa i përket programit profesional 2-vjeçar në “Multimedia dhe

⁷ Evidenca 9: Vendimi i këshillit të departamentit për përcaktimin e përfaqësuesit të karrierës

⁸ Evidenca 62: Vendimi i këshillit të departamentit për caktimin e këshilltarëve akademike

⁹ Evidenca 32: Marrëveshjet e bashkëpunimit (aktive) dhe mobiliteti për staf dhe studentë me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit - Marrëveshje mobiliteti për staf dhe studentë me Aurel Vlaicu Universita of Arad, Rumania dhe College of Applied Sciences, “Lavoslav Rurilita” in Vukovar, Kroaci në kuadër të programit Erasmus+

¹⁰ Evidenca 28: Lista IAL-ve me të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi.

¹¹ Evidenca 41: Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave të Komunikimit, viti akademik 2018-2019

¹² Evidenca 42: Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave të Komunikimit, viti akademik 2019-2020

¹³ Evidenca 33: Marrëveshjet e bashkëpunimit (aktive) me organizata, institucione dhe aktorët e biznesit vendas dhe ose të huaj dhe për praktikën profesionale

<p>Kriteri 2. Programet e studimeve me karakter profesional synojnë përfitim të njohurive gjithë përfshirëse të specializuara teorike dhe praktike brenda një fushe punësimi në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p>	<p>Të diplomuarit e programit profesional 2-vjeçar në “Multimedia dhe Dizajn Grafik”, zhvillojnë aftësi të qëndrueshme në ideimin, zbatimin dhe prezantim e produkteve multimediale; ata fitojnë eksperiencë reale nëpërmjet praktikave profesionale, pranë një game të gjerë organizatash dhe institucionesh lokale dhe ndërkombëtare. Gjithashtu, ata fitojnë njohuri mbi konceptet, teoritë themelore të fushës, historikun, trendet e zhvillimit të komunikimit multimodal. Aftësim për punë individuale dhe në grup, si dhe aftësi për t’iu përgjigjur kërkesave të tregut.</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit me karakter profesional synojnë pajisjen e studentëve me një sërë aftësish njohëse dhe praktike gjithëpërfshirëse që nevojiten për të zgjidhur në mënyrë krijuese probleme të karakterit profesional praktik.</p>	<p>Në dosjen e aplikimit për hapjen e programit, theksohet se në përfundim të programit akademik programit profesional në “Multimedia dhe Dizajn Grafik”, studentët e diplomuar zhvillojnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Aftësi të qëndrueshme komunikimi në shkrim dhe prezantim; • Aftësi profesionale nga ideimi deri tek implementimi; • Eksperiencë reale nëpërmjet praktikave profesionale, pranë një game të gjerë organizatash dhe institucionesh lokale dhe ndërkombëtare; • Njohuri mbi konceptet dhe teoritë themelore të fushës; • Aftësim për punë individuale dhe në grup; • Aftësi për t’iu përgjigjur kërkesave të një industrie dinamike dhe tërheqëse. <p>Referuar syllabuseve të lëndëve të programit profesional në “Multimedia dhe Dizajn Grafik”, në këtë program studimi zhvillohen kompetenca kyçe të avancuara, duke i gërshetuar me një qasje teorike dhe praktike për zbatimin e projekteve multimediale në organizata e institucione.¹⁶</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit me karakter profesional synojnë zhvillimin e kompetencave për menaxhimin dhe mbikëqyrje në kuadrin e veprimtarive profesionale dhe orientimin e duhur në situata të ndryshme e të ndryshueshme.</p>	<p>Programi profesional në “Multimedia dhe Dizajn Grafik” parashtron një strukturë të qartë të objektivave formuese, njohurive, rezultateve të të nxënit, aftësive dhe kompetencave që studenti përfiton në përfundim të ciklit dyvjeçar. Struktura dhe përmbajtja e programit është konceptuar duke mbajtur parasysh formimin bazë të studentëve në disiplinat e përgjithshme dhe formimin specifik që garantohet nga lëndë të caktuara me objektiva të parashikuara në aftësimin praktik. Ky program studimi përbën një risi për tregun shqiptar, pasi siguron një kombinim të dy disiplinave, multimedias dhe dizajnit grafik. Studentët e diplomuar nga ky program përfitojnë një formim të plotë në fushën e multimedias dhe dizajnit grafik, të cilat përputhen me kërkesat e tregut të punës, përfshi tregun e biznesit privat, atë të shoqërisë civile dhe tregun e punësimit që përbëhet nga institucionet publike, në të gjitha nivelet. Të gjitha elementet përbërës të programit janë të parashikuara dhe në formatin e syllabusit të çdo lënde, i cili është i arritshëm për studentin dhe publikun përmes faqes zyrtare në internet të institucionit.¹⁷</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni/njësia kryesore/kolegji profesional dhe njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë të organizimit, strukturës akademike dhe numrit e shkallës së kualifikimit të stafit akademik.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë, si njësi kryesore, dhe Departamenti i Shkencave të Komunikimit, si njësi bazë, disponojnë një strukturim organizativ në çdo shkallë të hierarkisë, duke iu përshtatur nevojave të programit të studimit dhe duke përmbushur detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p> <p>KU “Bedër së bashku me njësitë përbërëse është hapur me vendim të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, nr. 286, datë 6.4.2011.</p> <p>Njësia kryesore përbëhet nga katër departamente që funksionojnë si njësi bazë me objektiva dhe mision të qartë, të përcaktuara në rregulloret</p>

¹⁶ Evidenca 25: Dosja e plotë e aplikimit për programin profesional në “Multimedia dhe Dizajn Grafik”

¹⁷ Evidenca 47: Syllabuset e lëndëve

	<p>përkatëse:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Departamenti i Shkencave të Komunikimit; • Departamenti i Drejtësisë; • Departamenti i Shkencave Islame; • Departamenti i Edukimit dhe Gjuhës Angleze. <p>Nga sa më sipër njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.¹⁸</p>			
<p>Kriteri 6. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin profesional të studentëve, ku përfshihen dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që e karakterizojnë profilin profesional të programit.</p>	<p>Programi profesional në “Multimedia dhe Dizajn Grafik” ka objektiva të përcaktuara qartë për formimin e studentëve. Programi është ndërtuar në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor për formimin e studentëve në ciklin e parë të studimit dhe parashikon dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që fitojnë studentët në përfundim të tij. Kuadri ligjor ku mbështetet hartimi i këtij programi përcakton standardet karakterizuese të dijeve, aftësive dhe kompetencave profesionale, të cilat karakterizojnë profilin e programit të studimit. Këto elemente janë pjesë e dosjes së programit që është aprovuar nga MAS, si dhe janë të parashikuara në rregulloren e programit të studimit.^{19 20} Përmes një kurrikule të bazuar në objektiva të qarta, programit profesional 2-vjeçar në “Multimedia dhe Dizajn Grafik” synon të zhvillojë një botëkuptim të gjerë të teorive dhe praktikës në fushën e multimedias dhe dizajnit grafik.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

<p>Standardi II.1</p> <p>Programet e studimeve me karakter profesional janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të këtij niveli dhe mundësitë e punësimit</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>
<p>Kriteri 1. Programet e studimit të ciklit të parë, përmbajnë dhe japin informacionet e nevojshme për objektivat formues, rezultatet e</p>	<p>Kriteri 1. Programet e studimit të ciklit të parë, përmbajnë dhe japin informacionet e nevojshme për objektivat formues, rezultatet e pritshme të të nxënit, organizimin, strukturën, përmbajtjen, fushat e</p>

¹⁸ Shtojcë 1: Tabelat e stafit

¹⁹ Evidenca 25: Dosja e plotë e aplikimit për programin profesional në “Multimedia dhe Dizajn Grafik”

²⁰ Evidenca 5: Rregullorja e “Programit Profesional në Multimedia dhe Dizajn Grafik”

<p>pritshme të të nxënit, organizimin, strukturën, përmbajtjen, fushat e mundshme të punësimit apo të dhëna reale të punësimit të studentëve të diplomuar në këto programe.</p>	<p>mundshme të punësimit apo të dhëna reale të punësimit të studentëve të diplomuar në këto programe. Objektivat e programit janë të paraqitura edhe në rregulloren e programit të studimit. Rregullorja përmban edhe strukturën, fushat e ndryshme të punësimit. Programet e studimit të ofruara nga Departamenti i Shkencave të Komunikimit janë hartuar në përputhje me qëllimet dhe misionin e Kolegjit Universitar “Bedër” dhe janë në përputhje të plotë me misionin dhe fushën e veprimtarisë së këtij institucioni.</p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimit janë të organizuara në module/lëndë e aktivitete formuese, të vlerësuara me kredite, të ndara në vite e semestra e që janë në përputhje me përcaktimet vendëse e evropiane në fuqi.</p>	<p>Programi profesional në “Multimedia dhe Dizajn Grafik” është i strukturuar në 2 vite shkollore dhe 4 semestra të rregullt. Për t’u ofruar studentëve mundësi shtesë, ofrohen edhe semestra vere të zhvilluara me kohë të përshpejtuar. Zhvillohen gjithsej 27 lëndë të ndara sipas 2 viteve shkollore (14 lëndë në vitin e parë; 13 lëndë në vitin e dytë. Lëndë të detyrueshme janë 24. Lëndë me zgjedhje janë 3. Programi i studimit profesional në “Multimedia dhe Dizajn Grafik” është i organizuar në lëndë bazë të detyrueshme, lëndë karakterizuese, lëndë ndërdisiplinore dhe detyrime përmbyllëse, duke respektuar legjislacionin vendas në fuqi dhe Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ETCS).²¹</p> <p>Programi profesional në “Multimedia dhe Dizajn Grafik” ka këto kategori lëndësh:</p> <p>A – Lëndë Bazë – 18 ECTS – 15%; B – Lëndë Karakterizuese – 66 ECTS – 55%; C – Lëndë Ndërdisiplinore -15 ECTS – 12.5%; D – Lëndë Plotësuese -16 ECTS – 13.3%; E – Detyrime Përmbyllëse - 5 ECTS – 4.16%.</p> <p>Kjo ndarje respekton ligjin nr.80/2015 datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, udhëzimin nr. 15, datë 4.04.2008 “Për organizimin e studimeve në institucionet e arsimit të lartë”.</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ndjekjen e programit, vlerësimin e dijeve, aktivitete specifike etj.</p>	<p>Plani mësimor i programit të studimit profesional në “Multimedia dhe Dizajn Grafik” përmban të gjithë informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit.</p> <p>Mënyra e vlerësimit të dijeve tregohet në programet e lëndëve.</p> <p>Konkretisht, në përgjithësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 5-10 % pjesëmarrja; - 10-20 % plotësimi i detyrimeve (laboratorike, detyrave të kursit); - 20-30 % testimet gjatë vitit; - 40-50 % provimi përfundimtar; <p>Për frekuentimin e studentëve KU “Bedër” ka vendosur detyrim mbi 70%.</p> <p>Në planin mësimor janë përfshirë kreditet përkatëse për çdo lëndë apo aktivitet formues.</p> <p>Në syllabuse gjenden edhe format e frekuentimit dhe kontrollit të dijeve, si dhe mënyrat e vlerësimit dhe pikëzimit të studentit.</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikat, ushtrimet apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët e aktivitetet</p>	<p>Programet e lëndëve përmbajnë informacionet e nevojshme për leksionet, praktikat, seminarat apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit, në përputhje me formatet e miratuara dhe me një cilësi të mirë.</p>

formuese të programit të studimit.	Syllabuset për secilën lëndë janë të plota dhe të pajisura me të gjitha elementet e nevojshme. ²²			
Kriteri 5. Struktura dhe organizimi i programit të studimit është mjaftueshmërisht fleksibël për të mundësuar formimin e studentëve përgjatë programit dhe në përshtatje me punësimin.	Përmbajtja e programit të studimit profesional në “Multimedia dhe Dizajn Grafik” u ofron studentëve njohuri dhe dije bazë dhe specifike në këtë fushë. Niveli i njohurive është në përputhje edhe me nivelin e ciklit profesional të studimeve, duke krijuar bazat e duhura për mundësi punësimi. Lëndët që zhvillohen dhe sidomos programet e tyre janë të tilla, që krijojnë te studentët një bazë shumë të mirë teorike dhe praktike për zbatimin e tyre, në përshtatje me pritshmëritë dhe kërkesat e tregut e punës.			
Kriteri 6. Mësimi praktik dhe i elementeve të punës konkrete u është dhënë vendi dhe pesha e duhur në strukturë, vlerësim dhe rivlerësim.	Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori – praktikë dhe vlerësimi i praktikës është në përputhje me profilin e programit profesional. Struktura e programit është krijuar duke u bazuar në përvojën e stafit, brenda dhe jashtë vendit dhe është e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Rëndësi e veçantë u kushtohet lëndëve praktike, që zënë afërsisht 50 %. Lëndët me karakter praktik, zënë një vend të rëndësishëm në kurrikulën e programit. Vlerësimi i lëndëve bëhet duke përfshirë projekte që aftësojnë studentët në njohuritë praktike të tyre.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Struktura, plani mësimor dhe shpërndarja lëndore e programeve të studimit me karakter profesional, është në përputhje me objektivat formuese, rezultateve të të nxënit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve dhe kërkesave të tregut të punës për këto programe.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Emërtimi, struktura dhe shpërndarja e në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore është në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	Ashtu siç është parashikuar dhe në rregulloren themelore të KU Bedër, programi profesional në “Multimedia dhe Dizajn Grafik” funksionon në përputhje të plotë me “Procesin e Bolonjës” dhe kërkesat e ligjit “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”. Programi ka të përshkruara qartë objektivat dhe kompetencat profesionale. Në rregulloren e programit, krahas objektivave janë parashikuar gjithashtu rezultatet, organizimi i programit, mundësitë e punësimit të studentëve, gjuha e mësimdhënies dhe emërtimi i diplomës.
Kriteri 2. Emërtimi, struktura dhe shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit, rezultateve të pritshme të të nxënit dhe punësimin e studentëve.	Programi i studimit profesional në “Multimedia dhe Dizajn Grafik” parashtron një strukturë të qartë të objektivave formuese, njohurive, rezultateve të të nxënit, aftësive dhe kompetencave që studenti përfiton në përfundim të ciklit dy-vjeçar. Struktura dhe përmbajtja e programit është konceptuar duke mbajtur parasysh formimin bazë të studentëve në

	<p>disiplinat e përgjithshme dhe formimin specifik që garantohet nga lëndë të caktuara me objektiva të parashikuara në aftësimin praktik. Studentët e diplomuar nga ky program përfitojnë një formim të plotë në fushën e multimedias dhe dizajnit grafik, duke përfshirë disiplina, si krijimi i produkteve multimediale, komunikimin multimodal, komunikimin digjital, të cilat përputhen me kërkesat e tregut të punës, përfshi tregun e biznesit privat, atë të shoqërisë civile dhe tregun e punësimit që përbëhet nga institucionet publike, në të gjitha nivelet. Të gjitha elementet përbërëse të programit të lartpërmendur janë të parashikuara dhe në formatin e syllabus të çdo lënde, i cili është i arritshëm për studentin dhe publikun përmes faqes zyrtare në internet të institucionit.</p>
<p>Kriteri 3. Plani mësimor, natyra dhe emërtimi i moduleve/lëndëve, syllabusët e moduleve e të aktiviteteve formuese janë informuese dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara.</p>	<p>Programi profesional në "Multimedia dhe Dizajn Grafik" ka hartuar rregulloren për këtë program specifik studimi. Në rregullore, janë zbatuar kërkesat e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", i ndryshuar. Këto elemente janë të përcaktuara:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kreditet janë të ndërtuara sipas sistemit ECTS; - Kontrolli i dijeve dhe instrumentet e vlerësimit janë të ndërthurur nëpërmjet testimeve me shkrim, detyrave praktike dhe prezantimeve në grup dhe individuale, projekteve dhe tezave të diplomës; - Objektivat formuese dhe profesionale janë të saktësuar sipas detyrimeve ligjore; - Veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit janë të ndara në orë auditori, punë individuale, veprimtari praktike, provim diplome; - Lëndët dhe veprimtaritë formuese janë të ndara në të detyrueshme dhe me zgjedhje nga studentët; - Plani mësimor dhe programi lëndor (syllabus-et) janë të përcaktuar qartë; <p>Programi zbaton rregulloret institucionale në respektimin e Kodit të Etikës.</p>
<p>Kriteri 4. Ka një raport të balancuar midis moduleve/aktiviteteve të formimit teorik përkundrejt atyre praktike (50:50). Rreth 25% e programit i dedikohet aftësimin në praktikë/punë konkrete në profesion.</p>	<p>Modulet praktike dhe teorike janë të balancuara në raport 50:50. Njohuritë teorike vendosen në zbatim përmes lëndëve me karakter praktik si fotografia, vizatimi kreativ, media sociale.²³</p>
<p>Kriteri 5. Klasifikimi sipas aktiviteteve formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues dhe orientimin e studentit drejt studimeve të mëtejshme dhe/ ose në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Raportet e ndarjes së veprimtarisë formuese të planit mësimor të programit të studimit profesional në "Multimedia dhe Dizajn Grafik" është sipas përqindjeve përkatëse, bazuar edhe në legjisllacionin në fuqi.</p> <p>Kjo ndarje është në përputhje të plotë me kërkesat ligjore, duke lehtësuar transferimin dhe lëvizshmërinë e studentëve. Bazuar në lëndën specifike, programi i saj paraqet një shpërndarje të qartë të ngarkesës teorike dhe praktike për t'i mundësuar studentit procesin e mësimnxënies praktike. Për më tepër, programi i studimit ka përfshirë në kurrikulën e tij mundësi praktike në terren në kuadrin e lëndës praktika profesionale. Studentët duhet të fitojnë dhe të përmirësojnë njohuritë praktike në tema të ndryshme të marrëdhënieve publike dhe</p>

	komunikimit të marketingut që mund të hasin gjatë periudhës së praktikës në një kompani, agjenci, organizatë ose institucion. Gjatë lëndës së praktika profesionale, studentët duhet të përfshihen rregullisht në praktikën e tyre në kompani, agjenci, organizatë ose institucion dhe duhet të paraqesin dëshmi të pjesëmarrjes dhe angazhimit si parakusht për përfundimin e lëndës dhe diplomimin në fund të programit.			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi II.3

Përmbajtja e lëndëve, moduleve dhe formave të tjera formuese të programeve të studimit me karakter profesional është në përputhje me objektivat formuese, rezultatet e të nxënit dhe kërkesat e tregut të punës për këto programe

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programi i studimit përmban të dhëna të plota mbi përmbajtjen e moduleve/lëndëve të formimit teorik e praktik dhe aktivitetet e tjera të formimit sipas strukturës e planit të studimit.	<p>Plani mësimor i këtij programi studimi është i ndarë në 4 semestra me nga 30 kredite ECTS ose 750 orë mësimore secili, ku një ECTS është e barabartë me $750/30=25$ orë mësimore. Tabela e planit mësimor për programin e studimit profesional në "Multimedia dhe Dizajn Grafik" pasqyron ndarjen e ngarkesës së veprimtarive formuese, që karakterizojnë këtë program studimi, në komponentët mësimorë: a) mësim në auditor, si leksione, seminare, lëndë individuale, ushtrime, laboratorë, forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale, të zhvilluara në auditor; b) studim individual, si studim e punim relacionesh, detyrash apo projektsh; c) përgatitje për provime; d) përgatitje e tezës së diplomës; e) veprimtari të tjera, si praktika profesionale, praktika në terren apo internshipe pranë subjekteve publike ose private.²⁴</p> <p>Në këtë plan mësimor rëndësi e veçantë i kushtohet edhe përgatitjes së praktike profesionale të studentëve, nëpërmjet aplikimit të praktikave profesionale, internshipeve (kurrikulare dhe ekstrakurrikulare), detyrave dhe projekteve me karakter praktik, pjesëmarrjes në aktivitete të ndryshme kurrikulare dhe ekstrakurrikulare që kanë për qëllim arritjen e objektivave të programit të studimit, vëzhgimit dhe aplikimit në praktikë të koncepteve dhe teorive të mësuara në auditor me qëllim përvetësimin më të mirë të tyre nga ana e studentëve si zhvillimin e aftësive praktike profesionale. Nga sa më sipër, vihet re lehtësisht se me kalimin e semestrave pesha e ngarkesës mësimore praktike në auditorë rritet deri në masën 67% të ngarkesës totale në auditorë çka mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit për aftësimin profesional të tyre.</p>
Kriteri 2. Përmbajtja e programit të studimit është aktuale, i plotëson kërkesat e veçanta të profesionit dhe kërkesat për aftësitë shprehite e kërkuara/të pritshme nga punëdhënësit.	<p>Në rregulloren e programit theksohet se në përfundim të programit profesional në "Multimedia dhe Dizajn Grafik", studentët e diplomuar zhvillojnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - aftësi të qëndrueshme komunikimi në shkrim dhe prezantim; - aftësi profesionale nga ideimi deri tek zbatimi i produkteve multimediale dhe pritshmëritë e punëdhënësit, si dhe: - eksperiencë reale nëpërmjet praktikave profesionale, në organizata

²⁴ Evidenca 23: Lista e praktikave profesionale të studentëve

	<p>dhe institucione lokale dhe ndërkombëtare;</p> <ul style="list-style-type: none"> - njohuri mbi konceptet dhe teoritë themelore të fushës; - aftësim për punë individuale dhe në grup; - aftësi për t'iu përgjigjur kërkesave të një industrie dinamike dhe tërheqëse. <p>Hartimi i programit ka ardhur pas studimit të tregut, duke reflektuar kërkesat e veçanta të profesionit.</p>			
Kriteri 3. Përmbajtja parashikon zhvillimin e aftësive të transferueshme, e shtrirë edhe në modulet e përmbajtjen e tyre, gjatë zhvillimit të kurrikulës dhe në metodat e mësimdhënies dhe vlerësimit.	Përmbajtja e programit është e shtrirë në disa module, të cilat aftësojnë studentët gradualisht. Metodot e mësimdhënies dhe vlerësimit ndikojnë në zhvillimin e aftësive në mënyrë të vazhdueshme.			
Kriteri 4. Modulet dhe aktivitetet e formimit teorik e praktik/punë konkrete mundësojnë përftimin e njohurive, aftësive dhe shkathtësive ndërkurrikulare, të menduarit kritik, zgjidhjen e problemeve në kontekste konkrete, komunikimin dhe marrëdhëniet me të tjerë, si dhe orientimin cilësor në përvojën e punës.	Misioni i programit profesional në "Multimedia dhe Dizajn Grafik" është përgatitja e individëve të kualifikuar në fushën e multimedias, dizajnit grafik, në fushën e mediave të reja, marketingut të integruar dhe në fusha të ngjashme me to, nëpërmjet një filozofie arsimimi që ka në thelb vlerat universale, si edhe mbështetjen e kërkimit shkencor, me qëllim vënien në jetë të ideve dhe projekteve që ndikojnë në përmirësimin e jetës së njeriut dhe të mbarë shoqërisë, në përputhje edhe me zhvillimet e teknologjisë bashkëkohore. Lëndët kategorizohen në grupe të ndryshme me karakter praktik dhe teorik. ²⁵			
Kriteri 5. Bashkëpunimi me punëdhënësit, internship-i/përvoja praktike, tutorazhi, e vlerësimi i tyre në profesion është e mjaftueshme, e përshtatshme dhe garanton formimin praktik në përputhje me kërkesat e profesionit.	KU Bedër, veçanërisht Departamenti i Shkencave të Komunikimit u kushton rëndësi të veçantë praktikave profesionale sipas programeve përkatëse. Prandaj, gjatë verës dhe gjatë vitit akademik, studentët u ofrohet mundësia të ndjekin praktika profesionale pranë institucioneve, organizatave dhe bizneseve të ndryshme, me të cilat departamenti dhe institucioni ka marrëveshje të ndryshme bashkëpunimi. ²⁶			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X
Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional përmes politikave e udhëzimeve të posaçme dhe mbështetet në metodat dhe praktikat më të mira të fushës	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues të posaçëm, ngre struktura të posaçme dhe zhvillon mekanizma të vlerësimit e të	Institucioni merr masa për sigurimin e mbarëvajtjes së planit mësimor për çdo program. Rregullorja e programit përkatës është udhëzuesi i drejtpërdrejtë në lidhje me hartimin e planeve mësimore

²⁵ Evidenca 47: Syllabuset e lëndëve

²⁶ Evidenca 33: Marrëveshjet e bashkëpunimit (aktive) me organizata, institucione dhe aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj dhe për praktikën profesionale

<p>monitorimit të cilësisë së mësimdhënies dhe metodave të përdorura dhe aftësive të stafit të angazhuar, duke përfshirë aktivisht studentët në këtë proces. Rezultatet e këtyre vlerësimeve bëhen publike.</p>	<p>për secilin program dhe nxitjen e përdorimit të metodave të ndryshme bashkëkohore dhe inovative të mësimdhënies, duke iu përshtatur fushës së studimeve dhe industrisë që i përket kualifikimi i studentëve, llojit dhe specifikave konkrete të lëndëve.</p> <p>Institucioni harton politika dhe ka në funksion mekanizma të kontrollit të cilësisë. NJSBC-ja si strukturë ka në përbërje edhe përfaqësues të studentëve²⁷.</p> <p>KU Bedër organizon në mënyrë periodike aktivitete trajnimi në fushën e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Këto aktivitete synojnë zhvillimin e stafit në përdorimin e metodave të ndryshme inovative në fushën e mësimdhënies, të përshtatura sipas natyrës së programeve të studimit. Për semestrin akademik pranverë 2019-2020 dhe vjeshtë 2020-2021, institucioni hartoi një material udhëzues mbi metodat dhe platformat e mësimdhënies në distancë dhe realizoi trajnime online për përdorimin e platformës G-Suite për realizimin e procesit mësimor në kushtet e situatës së jashtëzakonshme të shkaktuar nga pandemia Covid-19. Këto udhëzues dhe aktivitete janë të publikuara në faqen zyrtare të internetit.^{28 29 30 31 32}</p>
<p>Kriteri 2. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra e kursit/eseja, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni e që është e përshtatshme për realizimin e programit të studimit.</p>	<p>Elementet e studimeve, të parashikuara në rregulloren e institucionit në përputhje me specifikën e programit të studimit, përfshijnë leksionet, seminarët, ushtrimet, praktikat mësimore e profesionale, provimet e ndërmjetme dhe përfundimtare, detyrat e kursit, projektet etj.³³</p> <p>Përveç kësaj, Departamenti i Shkencave të Komunikimit organizon udhëtime, vizita, leksione të hapura, konferenca ose workshop-e në mënyrë që të mbështesë procesin e mësimdhënies.</p> <p>Kolegji Universitar “Bedër” disponon dy laboratorë kompjuterikë me pajisje të kohës, në mënyrë që leksionet të jenë sa më të praktikueshme me detyra dhe ushtrime të posaçme sipas leksionit. Përveç leksioneve dhe seminareve, institucioni kujdeset që studentët të marrin pjesë në leksione të hapura me të ftuar të jashtëm në ambientet e KU Bedër ose në institucione të ndryshme.</p> <p>Këtu mund të përmendim vizitat e studentëve të programit profesional në “Multimedia dhe Dizajn Grafik” në agjencitë e dizajnit dhe mediave³⁴, si dhe vetëm vitin e fundit akademik janë realizuar disa leksione të hapura³⁵ me pjesëmarrjen e studentëve të programit profesional në “Multimedia dhe Dizajn Grafik” me të ftuar nga fusha të ndryshme.^{36 37}</p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik përdor forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, në përgjigje dhe të diversitetit dhe nevojave të studentëve.</p>	<p>Personeli akademik përdor metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me natyrën e programit të studimit për t’iu përgjigjur diversitetit dhe nevojave të studentëve. Stafi vë në zbatim metoda bashkëkohore të mësimdhënies, që rishikohen çdo vit sipas nevojave të studentit. KU “Bedër” është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies. Ky proces kontrollohet periodikisht nga strukturat e brendshme të institucionit, konkretisht nga NJSBC.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në</p>	<p>Monitorimi dhe vlerësimi bëhet në mënyrë periodike dhe ofron të</p>

²⁷ Evidenca 53: Anketë vlerësuese për lëndën dhe pedagogun nga studentët

²⁸ Evidenca 59: Udhëzim mbi mësimdhënien në distancë

²⁹ Evidenca 34: Plani strategjik Institucional i KU Bedër 2018-2023

³⁰ https://drive.google.com/file/d/1ObEG3t7MHd_rgl1541YR-kw_T0BUY76Q/view?usp=drivesdk

³¹ <https://youtu.be/-fLD-A6F28w>

³² <https://youtu.be/Yt7feKFPcCk>

³³ Evidenca 49: Syllabusët e lëndëve “Vizatim Kreativ” dhe “Fotografi”

³⁴ Evidenca 22: Lista e kompanive që janë vizituar nga studentët

³⁵ Evidenca 27: Lista e të ftuarve në leksionet e hapura

³⁶ Evidenca 42: Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave të Komunikimit, viti akademik 2019-2020

³⁷ Evidenca 43: Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave të Komunikimit, viti akademik 2020-2021

<p>mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies, përfshirë ato interaktive e gjithëpërfshirëse, sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>dhëna të rëndësishme për të kuptuar nivelin e aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik. Monitorimi dhe vlerësimi i aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik³⁸ dhe ndihmës akademik realizohet nëpërmjet anketimeve.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Anketa vetëvlerësuese e stafit akademik³⁹ – plotësohet nga personeli akademik dhe përgjegjësi i departamentit përkatës në fund të çdo viti dhe ka për qëllim: <ul style="list-style-type: none"> a. Të njohë progresin që ka pasur stafi akademik gjatë vitit të kaluar; b. Të përcaktojë mënyrat nëpërmjet të cilave performanca e tyre mund të përmirësohet dhe të zhvillohet për t'i shërbyer si individit, ashtu edhe institucionit; c. Të mbështesë dhe të zhvillojë qëllimet për vitin e ardhshëm; d. Të rishikojë zhvillimin e karrierës; e. Të përcaktojë fushat e trajnimit dhe zhvillimit në mënyrë që të përmbushë misionin dhe qëllimet; f. Të përcaktojë treguesit e cilësisë në mësimdhënie, kërkim shkencor dhe publikime. <p>Një proces i tillë synon të sjellë përmirësim të vazhdueshëm dhe zhvillim në performancën e individit dhe efektshmërinë e institucionit. Stafit akademik merr përsipër të arrijë pritshmëritë e punës së tij dhe përmbushjen e qëllimeve të tij në të mirë të zhvillimit të interesave të institucionit.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Anketa vlerësuese e studentit për stafin akademik⁴⁰ ka për qëllim marrjen e informacionit në lidhje me cilësinë dhe metodat e mësimdhënies së stafit akademik, vlerësimin të dijeve ndaj studentëve të këtij institucioni. Anketa plotësohet nga studentët për çdo lëndë dhe pedagog, përbëhet nga nëntë pyetje dhe për çdo pyetje ka 5 mundësi zgjedhjeje. Të dhënat nga ky anketim janë të rëndësishme për politikën e ardhshme akademike dhe të mësimdhënies nga Kolegji Universitar “Bedër”. Ky anketim zhvillohet 2 herë në çdo vit akademik në përfundim të semestrit. <p>Anketa të posaçme realizohen në raste të veçanta për të kuptuar problematikat e ndryshme që mund të ndodhin dhe të ndikojnë në cilësinë e procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies, ku hyjnë vështirësitë nga ana e studentëve për të ndjekur procesin mësimor për shkaqe të veçanta, forca madhore etj. Një shembull i tillë është anketa e posaçme e realizuar nga NJBSC-ja me studentët në vitin 2020 në kushtet e situatës së jashtëzakonshme të shkaktuar nga pandemia Covid-19, me anë të të cilës synohej të kuptoheshin vështirësitë dhe problematikat e studentëve për të ndjekur procesin e mësimin online në kushtet e karantinës, me qëllim përshtatjen e këtij procesi sa më pranë nevojave të studentëve.⁴¹</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të mbështesë stafin përmes njohjes me shembujt e praktikave të mira, të nxisë dhe të inkurajojë personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Duke synuar garantimin e cilësisë në mësimdhënie, si edhe kualifikimet e personelit në fushën profesionale dhe atë të kërkimit shkencor, KU “Bedër” gjatë kësaj periudhe ka organizuar disa trajnime, të cilat janë mbështetur nga NJSBC dhe zyra e burimeve njerëzore. NJSBC propozon trajnime për stafin të burimet njerëzore. Institucioni promovon shembuj të praktikave më të mira, si dhe inkurajon dhe motivon stafin akademik për të përmirësuar më tej</p>

³⁸ Evidenca 29: Lista me CV-të e stafit

³⁹ Evidenca 6: Rregullorja e anketave dhe vlerësimeve, Neni 3

⁴⁰ Evidenca 6: Rregullorja e anketave dhe vlerësimeve, Neni 14

⁴¹ Evidenca 51: Anketa e posaçme realizuar në kushtet e pandemisë Covid-19

	<p>mësimdhënien, duke organizuar aktivitete të ndryshme trajnimi, leksione të hapura dhe seminare me profesorë të ftuar nga universitete të shquara. Nga ana tjetër, institucioni është i përfshirë në projekte të ndryshme ndërkombëtare, si dhe ka nënshkruar memorandum mirëkuptimi me universitete ndërkombëtare, përmes të cilave motivon stafin të marrë pjesë në programet e mobilitetit të stafit si Erasmus+, për të përmirësuar aftësitë e tyre mësimdhënëse. Gjithashtu, institucioni promovon shembujt e praktikave më të mira përmes mjeteve të tij të komunikimit, siç janë emaili ose faqja e internetit e KU Bedër.</p> <p>Vlerësimi dhe promovimi i praktikave të mira bëhet nga eprorët në raportet vjetore të njëjve të ndryshme akademike dhe administrative të institucionit, si dhe në takimet me personelin akademik dhe administrativ dhe aktivitetet e ndryshme promovuese.^{42 43 44}</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2	
<p>Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike të nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor</p>	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Procesi mësimor teorik e praktik, realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.</p>	<p>Procesi i mësimdhënies kryhet në ambiente të përshtatshme dhe cilësore, të cilat mirëmbahen dhe ruhen si duhet.</p> <p>Varësisht nevojave të programeve akademike, KU Bedër ofron mjedise që ndihmojnë studentin për formimin praktik dhe profesional. Të tilla janë: Multimedia Lab, redaksia, laboratorit i gjuhëve të huaja, laboratorit i kompjuterave, salla e gjyqit, klinika e ligjit etj.</p> <p>Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit. Auditorët janë të pajisura me mjetet e nevojshme teknologjike, si tabelë interaktive, projektorë, kompjuter, internet. Të gjitha mjediset mësimore janë të pajisura me kondicionim dhe ndriçim të mjaftueshëm.</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor, si dhe sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.</p>	<p>Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme kompjuterike hardware dhe software, në kuadër të plotësisht të kërkesave të procesit mësimor. Klasat janë të pajisura me kompjutera, linja internet dhe projektorë. Gjithashtu çdo individ (pedagog, student) është i pajisur me llogarinë e tij të postës elektronike @beder.edu.al me memorie të pakufizuar të Google Drive dhe sharing, Google Classroom etj. Gjithashtu, me anë të kësaj adrese emaili, studentët aksesojnë llogarinë e tyre personale në Sistemin Interaktiv Bedër (BIS) të sistemit të</p>

⁴² Evidenca 41: Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave të Komunikimit, viti akademik 2018-2019

⁴³ Evidenca 43: Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave të Komunikimit, viti akademik 2020-2021

⁴⁴ Evidenca 15: Certifikata pjesëmarrje të personelit akademik në aktivitete ndërkombëtare

	<p>brendshëm nga ku mund të ndjekin notat e tyre dhe të gjitha çështjet e tjera që lidhen me marrëdhëniet e tyre me KU “Bedër”⁴⁵</p> <p>G-SUITE me shërbimet e saj është platforma online, e përdorur për më tepër për realizimin e procesit mësimor dhe komunikimin me studentët gjatë periudhës së pandemisë COVID-19. Gjithashtu, përmes G-Suite çdo pedagog ndan materialet e leksioneve, studentët dorëzojnë projektin e tyre ose detyrat e ndryshme dhe aktivitete të tjera të ngjashme, të nevojshme për lëndën specifike. Ka akses në internet në të dyja ndërtesat dhe dy laboratorët e kompjuterave janë të pajisur me windows: MS Office, Adobe, SAP2000, ETABS, .Net Visual Studio C ++, Matlab, GNS3 e fundit, Multisim 11, VMWare Workstation, MySQL \ Workbench, Eclipse, Python (x, y), Rhinoceros 4 SR8 + Vray, 3DMAX dhe SPSS.</p>
<p>Kriteri 3. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Institucioni vë në dispozicion një numër të konsiderueshëm të teksteve bazë dhe literaturë ndihmëse në ambientet e bibliotekës së Kolegjit Universitar “Bedër”. Literatura është bashkëkohore dhe pasqyrohet në programet e lëndëve. Bazuar në kërkesat e stafit akademik, kjo literaturë zgjerohet dhe vihet në shërbim të studentëve.⁴⁶</p> <p>Pedagogu i lëndës zgjedh dhe përditëson literaturën bazë dhe ndihmëse në bazë të nevojës së lëndës dhe silabuseve të përcaktuara. Literatura e nevojshme për lëndët e ofruara, bëhet e ditur me anë të programit të lëndës që në fillim të semestrit. Pedagogët e lëndëve kërkojnë nga departamenti që të sigurohen në bibliotekë të paktën disa kopje nga literatura e nevojshme. Biblioteka zotëron titujt kryesorë të përfshirë në literaturën e domosdoshme të çdo programi.</p>
<p>Kriteri 4. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Studentët dhe pedagogët kanë akses në sistemin online të bibliotekës. Sipas këtij sistemi, kërkesa për sigurimin e literaturës dhe regjistrimet e studentëve bëhen në formë elektronike.</p> <p>Lista e të gjithë titujve dhe librave të bibliotekës gjendet online. KU “Bedër” ka anëtarësim të plotë në JSTOR, një bibliotekë e përbashkët digjitale e krijuar në 1995, që përfshin më shumë se 2000 revista akademike. JSTOR u themelua për të ndihmuar bibliotekat dhe botuesit akademikë të kalojnë aktivitetet e tyre nga printimi në operacione digjitale, për të zgjeruar aksesin e teksteve shkencore në të gjithë botën, si edhe për t’i ruajtur ato për brezat e ardhshëm. (Shto përshkrimin sipas tabelës)</p> <p>Çdo anëtar i stafit të KU Bedër dhe studentët mund të hyjnë në koleksionet e JSTOR duke u futur në http://www.jstor.org/ ose me anë të llogarisë mail të institucionit.^{47 48}</p>
<p>Kriteri 5. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>KU “Bedër” disponon dy salla laboratorike me kompjutera të kohës, të shfrytëzueshme nga studentët për realizimi e detyrave, projekteve dhe studimeve specifike gjatë orareve mësimore dhe pas tyre.</p> <p>Në periudhat e sezonit të provimeve sallat laboratorike dhe biblioteka e KU “Bedër” janë të hapur edhe gjatë fundjavës dhe në dispozicion të studentëve për përgatitjen e tyre.</p>

⁴⁵ Evidenca 60: Udhëzues i sistemit informativ (BIS)

⁴⁶ Evidenca 31: Marrëveshja për akses në JSTOR

⁴⁷ Shtojca 1: Të dhëna të plota për platformat on-line/Struktura e teknologjisë së informacionit/ Biblioteka/ Biblioteka online, etj. (Tabela 17)

⁴⁸ Evidenca 31: Marrëveshja për akses në JSTOR

	Laboratorët shfrytëzohen nga studentët nën monitorimin dhe udhëheqjen e stafit përkatës akademik dhe ndihmës. ⁴⁹			
Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	<p>Platforma G-Suite e institucionit ofron shërbime, si: mail, hapësirë pa limit drive, video-konferenca, klasa virtuale, prezantime, teste ose quize on-line, detyra dhe vlerësime për këto.</p> <p>Gjatë periudhës së pandemisë Covid-19, kjo platformë siguroi vazhdimësinë e pandërprerë të procesit mësimor akademik në komunikimet e vazhdueshme dhe realizimin e seancave të procesit mësimor.</p> <p>Sistemi i komunikimit të brendshëm elektronik dhe hapësira vetjake e dedikuar mundësohet nëpërmjet platformës G-Suite si për stafin akademik, administrativ, ashtu edhe për studentët e ciklit të parë dhe të dytë të regjistruar në institucion.</p> <p>Secili nga studentët, në momentin e regjistrimit, pajiset me një adresë emaili në formatin (iniciali i emrit, mbiemri, viti i regjistrimit @beder.edu.al).</p> <p>Stafi akademik dhe administrativ është i pajisur me adresë emaili në formatin (iniciali i emrit, mbiemri@beder.edu.al).⁵⁰</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3	
Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat garantojnë cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit dhe rritjen e vetëdijes për përmirësimin e tyre	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që ndjekin, vlerësojnë dhe monitorojnë procesin e mësimdhënies dhe koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së saj.	Aspekti i përmirësimit të vazhdueshëm të mësimdhënies në nivel institucional, organizohet dhe drejtohet nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Kjo njësi ka krijuar një përvojë të mirë në menaxhimin e këtij procesi. Institucioni ka ngritur Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë Institucionale, i cili është organ kolegjal që kryen funksione në lidhje me garantimin e standardeve të cilësisë institucionale dhe programeve të studimit. ⁵¹
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për procesin e mësimdhënies, cilësinë e saj dhe rritjen e vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.	Përveç organizimit në nivel institucioni, sigurimi i cilësisë është i organizuar edhe në nivel njësie kryesore dhe në nivel njësie bazë, të cilat harmonizojnë dhe koordinojnë punën për të përmirësuar cilësinë në mësimdhënie. Rregullorja e NJSBC-së përcakton mënyrën e organizimit dhe detyrat që kanë njësitë në nivel fakulteti dhe departamenti. Ndërkohë nëpërmjet anketimeve të kryera nga studentët dhe vlerësimit të bërë nga titullari i njësisë,

⁴⁹ Evidenca 58: Udhëzim mbi funksionimin e bibliotekës

⁵⁰ Evidenca 60: Udhëzues i sistemit informativ (BIS)

⁵¹ Evidenca 11: Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e KP për garantimin e standardeve të cilësisë

	personeli akademik ka mundësi të rrisë shkallën e vetëdijësisë për sa i përket procesit të sigurimit të cilësisë. ^{52 53 54 55 56 57 58} http://qac.beder.edu.al/
Kriteri 3. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja, në përputhje me natyrën dhe specifikën e programeve profesionale.	Bazuar në Statutin e KU “Bedër”, si dhe në Planin Strategjik Institucional, stafi akademik i programit profesional në “Multimedia dhe Dizajn Grafik” dhe stafi mbështetës, si koordinatori dhe departamenti, zyra e administratorit të fakultetit etj., janë përgjegjës për zbatimin e duhur të programit të studimit dhe janë të angazhuar për të përmirësuar mësimdhënien dhe zbatimin e metodave të reja përmes ndjekjes së vazhdueshme të planeve dhe strategjive të hartuara për këtë qëllim. ^{59 60 61}
Kriteri 4. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies përmes trajnimeve të vazhdueshme të personelit akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të tyre.	Departamenti i Shkencave të Komunikimit si njësi bazë për cilësinë e mësimdhënies, si dhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC)- si struktura kryesore në nivel institucional për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies. ^{62 63} Metodat kryesore përfshijnë përfitimin e njohurive përmes teksteve të lëndës, leksioneve ppt, prezantimeve individuale dhe në grup, projekteve kërkimore, leksioneve të hapura, aplikime studimore, ndërveprimet me të ftuar nga industria që vizitojnë institucionin, praktika profesionale, vizita në terren, aktivitete vullnetare, projekte dhe anëtarësime në klubet studentore dhe aktivitete të tjera jashtë shkollore. ⁶⁴ Eksperimentimi dhe zhvillimi i metodave të reja të mësimdhënies janë çështje që lidhen si me anën infrastrukturore të institucionit, ashtu edhe me strategjinë e cilësisë së KU “Bedër”. Nga mbikëqyrja e ambienteve dhe auditorëve në institucion, vihet re se zhvillimi i metodave të reja të mësimdhënies është plotësisht i mundur. ⁶⁵
Kriteri 5. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	KU “Bedër” zhvillon aktivitete të ndryshme, në të cilat personeli akademik dhe ndihmës trajnohen dhe teston metoda të reja, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse mësimore. Këto trajnime realizohen kryesisht në kuadër të shkëmbimeve ndërkombëtare për trajnimin e stafit, apo aktiviteteve të mirëfillta trajnuese, të organizuara nga departamenti. Aktivitetet trajnuese, objektivat, efektet dhe pritshmëritë analizohen dhe raportohen në strukturat përkatëse. Raportet janë të aksesueshme edhe në faqen e internetit. Metodat e ndryshme të mësimdhënies përfshijnë leksione jashtë auditorit nëpërmjet vizitave në ambiente të ndryshme pune, nëpërmjet realizimit të takimeve, madje dhe testeve atje ku

⁵² Evidenca 12: Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC-së

⁵³ Evidenca 56: Shkresa nga NJSBC te HR

⁵⁴ Evidenca 6: Rregullorja e anketave dhe vlerësimeve

⁵⁵ Evidenca 53: Anketa vlerësuese për lëndën dhe pedagogun nga studentët

⁵⁶ Evidenca 51: Anketa e posaçme realizuar në kushtet e pandemisë Covid-19

⁵⁷ Evidenca 39: Procedura e vlerësimit të performancës së stafit akademik

⁵⁸ Evidenca 52: Anketa Vlerësuese nga Stafi Akademik ndaj institucionit

⁵⁹ Evidenca 2: Statuti i Kolegjit Universitar “Bedër”

⁶⁰ Evidenca 34: Plani strategjik Institucional i KU Bedër 2018-2023

⁶¹ Evidenca 61: Vendim i këshillit të departamentit për ngarkesën mësimore

⁶² Evidenca 26: Lista e trajnimeve të stafit

⁶³ Evidenca 16: Dokument i pjesëmarrjes në Bologna Hub Peer Support

⁶⁴ Evidenca 21: Lista e aktiviteteve dhe vizitave studimore të studentëve

⁶⁵ Evidenca 34: Plani strategjik Institucional i KU Bedër 2018-2023

	<p>nesër të diplomuarit e këtij program do të punojnë. Detyrat dhe projektet bazohen në raste reale konkrete të zhvillimit kombëtar dhe ndërkombëtar të teknologjisë, multimedias dhe dizajnit grafik. Angazhimet në grupe pune janë një element shumë i rëndësishëm në procesin e mësimdhënies, i cili ka marrë prioritet në format e trajtimit të projekteve si brenda, ashtu edhe jashtë lëndëve mësimore. Në këto projekte studentët mësojnë të bashkëpunojnë, të tolerojnë, por edhe të kërkojnë llogari, të angazhohen si pjesë e një grupi dhe gjithashtu të vlerësojnë studentët e tjerë për përkushtimin dhe kontributin e tyre. Këto forma analizohen midis pedagogëve dhe studentëve në fund të semestrit për të parë përfitimet dhe nevojat për përmirësim të vazhdueshëm. Të mësuarit nëpërmjet projekteve, në metodën e të nxënies bazuar në punën me projekte është një formë e preferuar e mësimdhënies dhe e përdorur gjatë zhvillimit të lëndëve.⁶⁶ Produktet që dalin nga kjo metodë, si postera, video etj. publikohen dhe prezantohen gjerësisht te studentët e grupeve, duke shërbyer edhe si modele nën këshillimin e lektorëve gjatë krijimit dhe prezantimit të tyre. Rezultatet e të nxënies, të parashikuara në syllabus, rishikohen, me qëllim që këto objektiva t'u shërbejnë sa më mirë studentëve edhe me zhvillimet e reja të teknologjisë, koncepteve, praktikave, zgjidhjeve etj., që i përkasin dizajnit grafik dhe multimedias.^{67 68}</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X
<p>Standardi III.4</p> <p>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme për vlerësimin e njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën për çdo student.</p>				
Kriteret	Vlerësimi			
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, të cilat bëhen publike. Institucioni mban dhe ruan dokumentacionin e vlerësimeve, ankimmimet dhe rishqyrtimet e vlerësimit, sipas afateve e procedurave në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Kolegji Universitar “Bedër” i pajis studentët me Guidën e Studentit⁶⁹, e cila informon studentët për të gjitha rregulloret, proceset, politikat dhe mekanizmat që udhëheqin studimet e tyre. Ky dokument është i publikuar edhe në faqen e zyrtare të KU “Bedër”.</p> <p>Rregullorja Themelore e KU “Bedër”, rregullorja e fakultetit, rregullorja e programit profesional në “Multimedia dhe Dizajn Grafik”, rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë parashikojnë në mënyrë të qartë, modalitetin e vlerësimit dhe përcaktojnë format e ndryshme të vlerësimit që mund të aplikohen nga pedagogët në lëndët e ndryshme. Procesi i vlerësimit përfshin një shumatore të vlerësimit të vazhdueshëm dhe atij përfundimtar. Pësia specifike e komponentëve të vlerësimit është specifike dhe ndryshon nga lënda në lëndë.</p> <p>Në përgjithësi: -5-10 % pjesëmarrja;</p>			

⁶⁶ Evidenca 48: Syllabus lënda “Dizajn Grafik”

⁶⁷ Evidenca 42: Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave të Komunikimit, viti akademik 2019-2020

⁶⁸ Evidenca 43: Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave të Komunikimit, viti akademik 2020-2021

⁶⁹ Evidenca 18: Guida e Studentit

	<p>-10-20 % plotësimi i detyrimeve (laboratorike, detyrave të kursit);</p> <p>-20-30 % testimet gjatë vitit;</p> <p>-40-50 % provimi përfundimtar.</p> <p>Rregulloret janë të publikuara në website-n e KU “Bedër”.</p>
<p>Kriteri 2. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Pedagogët përdorin forma të ndryshme vlerësimi për t’u dhënë mundësi studentëve që të mund të shprehin dhe paraqesin njohuritë dhe aftësitë e fituara gjatë lëndës përkatëse. Këto forma përfshijnë: testime gjysmëfinale, projekte, detyra kursi, kuice, punë në grup, raste studimore, analiza, prezantime, aplikime në raste konkrete reale, provime finale. Këto forma u japin mundësi studentëve jo vetëm të tregojnë aftësitë e tyre dhe njohuritë e fituara, por edhe të njohin forma të ndryshme të aplikimit të këtyre njohurive dhe aftësive, të zhvillojnë aftësitë e punës në grup, aftësitë e komunikimit me njëri-tjetrin dhe me palët e treta, të zhvillojnë aftësitë prezantuese, analizuese dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e situatës.</p> <p>Në javën e parë të semestrit akademik, pedagogu informon studentët mbi programin lëndor, i cili përmban informacion mbi: përmbajtjen e lëndës të organizuar në javë, objektivat e lëndës, rezultatet e të nxënit të lëndës, literaturën e nevojshme dhe materialet e tjera të lëndës, metodën e vlerësimit të lëndës, shpërndarjen e ngarkesës etj. Syllabuset e lëndëve janë të publikuara në Sistemin Interaktiv Bedër – BIS.^{70 71}</p>
<p>Kriteri 3. Në fillim të çdo lënde/moduli, studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës /modulit.</p>	<p>Në syllabusin përkatës të lëndës, pedagogu përcakton në mënyrë të detajuar kërkesat dhe detyrimet që duhen përmbushur nga studentët gjatë semestrit, së bashku me mënyrën e vlerësimit për këto detyrime.</p> <p>Këto u komunikohen studentëve në fillim të semestrit nga pedagogu dhe janë gjithashtu të publikuara në systemin BIS në hapësirën e dedikuar lëndës përkatëse në të cilën kanë akses studentët dhe pedagogu i lëndës.</p> <p>Syllabuset e lëndëve për të gjitha semestrat kur është dhënë kjo lëndë janë gjithashtu të publikuara në websiten e institucionit në seksionin e programit përkatës com.beder.edu.al^{72 73}</p>
<p>Kriteri 4. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik, duke venë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat garantojnë anonimat, eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Testimi e vlerësimi i nivelit të suksesit të studentëve të programit realizohet përgjatë gjithë semestrit akademik.</p> <p>Gjatë një semestri janë përcaktuar dy periudha kohore të dedikuara për provimet; provimet e ndërmjetme- gjysmëfinale (java e 8 e semestrit) dhe provimet përfundimtare- finale (përfundimi i semestrit, java 16 e semestrit).</p> <p>Ndërmjet tyre, studentët testohen me kuize, teste, projekte, detyra, pjesëmarrje në mësim etj. Sipas syllabusit përkatës. vlerësohet mbi bazën e provimeve semestrale; pjesëmarrjes aktive në mësim; detyrave të kursit; prezantimeve; aktivizimeve dhe projekteve.⁷⁴</p> <p>Vlerësimi i lëndës bëhet sipas modaliteteve të përcaktuara për lëndën në syllabusin e saj.⁷⁵</p> <p>Sipas rregullores së KU “Bedër”, duhet të ketë të paktën një</p>

⁷⁰ Evidenca 47: Syllabuset e lëndëve

⁷¹ Shtojca 1: Format e kontrollit të njohurive (Tabela 15)

⁷² Shtojca 1: Format e kontrollit të njohurive (Tabela 15)

⁷³ Evidenca 55: Shembull Syllabusi

⁷⁴ Evidenca 3: Rregullorja themelore e Kolegjit Universitar “Bedër”, neni 78

⁷⁵ Evidenca 47: Syllabuset e lëndëve

	<p>testim mes-semesteral dhe një përfundimtar për secilën lëndë në semestër.⁷⁶</p> <p>KU “Bedër” disponon sistemin e brendshëm BIS ku bëhet komunikimi dhe ruajtja e të gjitha vlerësimeve të studentit sipas lëndëve përkatëse. Gjithashtu mund të aplikojë teste me forma elektronike, ku korrigjimi bëhet në mënyrë automatike. Kjo realizohet nëpërmjet formave të testeve në platformën G-Suite.</p>			
<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisione provimi, shoqërohet me komente e këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Shpallja e rezultateve shoqërohet me shpjegimet përkatëse të përgjigjeve të sakta dhe me çelësin e tezës së provimit. Në rastet e nevojshme, pedagogu është i gatshëm të bëjë sqarimet e nevojshme për studentët që kërkojnë këtë. Po ashtu pedagogu mund të shtojë kohën e nevojshme për përvetësimin e njohurive nga ana e studentëve ose këtë mund ta bëjë me një grup të vogël studentësh.</p>			
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse, duke garantuar njëkohësisht të drejtat e studentëve, për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me këto rregullore.</p>	<p>Kolegji Universitar “Bedër” bën të ditur kalendarin e tij akademik në fillim të çdo viti akademik. Afatet e përfundimit të vlerësimit të dijeve dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara qartë dhe të shpallura në kalendarin akademik. Ky kalendar pasqyrohet edhe në sistemin e brendshëm BIS, i cili është mënyra zyrtare e afishimit të rezultateve. Stafu akademik është i detyruar të ndjekë kalendarin, sipas rregullores së sistemit.</p> <p>Finalizimi i notave realizohet me anë të sistemit interaktiv BIS, në përgjithësi maksimalisht një ose dy javë pas periudhës së provimit përfundimtar.</p> <p>Dosja e provimit është e plotë në përmbajtje, duke përfshirë fletët e provimit, fletë-përgjigje, një kopje të pikëve të provimit përfundimtar dhe dy kopje të notave përfundimtare.⁷⁷</p> <p>Sipas rregullores së programit profesional në “Multimedia dhe Dizajn Grafik”, në rast se studenti ka ankesa ndaj rezultatit përfundimtar të një provimi, ai ka të drejtë që, brenda një jave nga dita e publikimit të rezultateve, të paraqesë një ankesë me shkrim te zyra e sekretarisë mësimore.</p> <p>Ankimi shqyrtohet mbi gabimet materiale, nga një komision i cili ngrihet me vendim të këshillit të departamentit përkatës dhe përbëhet prej tre anëtarësh. Pedagogu i lëndës nuk mund të jetë pjesë e këtij komisioni. Vendimi i bëhet i ditur studentit jo më shumë se 15 ditë nga dita e paraqitjes së kërkesës për rishikim. Kjo procedurë dokumentohet dhe arkivohet pranë departamentit.⁷⁸</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

⁷⁶ Shtojca 1: Format e kontrollit të njohurive (Tabela 15)

⁷⁷ Evidenca 7: Rregullorja e programeve të studimit të ciklit të parë

⁷⁸ Evidenca 5: Rregullorja e “Programit Profesional në Multimedia dhe Dizajn Grafik”

Standardi III.5

Zhvillimi i programit të studimit, deri në diplomim, garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët duke dhënë njëkohësisht njohuri të aplikuara dhe kompetenca profesionale lehtësisht të përdorshme në tregun e punës, apo për studime të mëtejshme.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë përfitim të njohurive, zhvillimin e aftësive profesionale dhe të veçanta të studentëve, që janë në përputhje me rezultatet e pritura të të nxënësve për programet me karakter profesional.</p>	<p>Programi profesional në “Multimedia dhe Dizajn Grafik” u ofron studentëve njohuri dhe dije bazë dhe specifike në këtë fushë. Krahas njohurive teorike, programi synon aftësimin praktik të studentëve nëpërmjet laboratorëve dhe praktikave.⁷⁹</p> <p>Lëndët e programit profesional në “Multimedia dhe Dizajn Grafik” zhvillohen duke u dhënë rëndësinë e duhur teorisë, seminareve, projekteve, rasteve studimore dhe apo ashtu praktikave profesionale. Nëpërmjet marrëveshjeve me kompani të ndryshme në vend, KU “Bedër” u siguron studentëve praktika profesionale cilësore, duke filluar që nga viti i parë.</p> <p>Vlen për t’u përmendur këtu angazhimi i studentëve në redaksinë e informacionit të portalit informativ www.objektiv.al</p> <p>Përveç kurrikulës, studentët marrin pjesë rregullisht në aktivitete jashtëkurrikulare, siç janë forume të hapura, vizita në terren, konferenca studentore etj.⁸⁰⁸¹</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton njohuritë e përshtatshme dhe zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit, duke mbështetur diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave apo çështjeve të caktuara.</p>	<p>Programi profesional në “Multimedia dhe Dizajn Grafik” është i fokusuar në risitë bashkëkohore dhe ato të komunikimit. Stafi është i kujdesur që të përditësojë kurrikulat dhe syllabuset sipas kërkesave të kohës duke përfshirë të rejtat e teknologjisë.</p> <p>Programi profesional në “Multimedia dhe Dizajn Grafik” ka këto kategori lëndësh:</p> <p>A – Lëndë bazë – 18 ECTS – 15%</p> <p>B – Lëndë karakterizuese – 66 ECTS – 55%</p> <p>C – Lëndë ndërdisiplinore -15 ECTS – 12.5%</p> <p>D – Lëndë plotësuese -16 ECTS – 13.3%</p> <p>E – Detyrime përmbyllëse - 5 ECTS – 4.16%</p> <p>Kjo ndarje respekton ligjin nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, udhëzimin nr. 15, datë 4.04.2008 “Për organizimin e studimeve në institucionet e arsimit të lartë, si dhe vendimin e KM nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”.⁸²</p>
<p>Kriteri 3. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale, duke garantuar realizimin në praktikë të marrëveshjeve me punëdhënësit e aktorët e biznesit në përfitim të formimit praktik të studentëve. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar formimin</p>	<p>Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash, të cilat janë të mirëpërcaktuara në programet lëndore. Studentët e programit profesional në “Multimedia dhe Dizajn Grafik” kanë në dispozicion infrastrukturën e nevojshme dhe e përdorin atë për të zhvilluar njohuritë e marra në laboratorët kompjuterikë, në laboratorin e multimedias, në redaksinë e portalit www.objektiv.al, si dhe në praktikat profesionale.</p> <p>Departamenti ka ndërmjetësuar disa marrëveshje bashkëpunimi midis Kolegjit Universitar “Bedër” me institucione të tjera brenda</p>

⁷⁹ Evidenca 5: Rregullorja e “Programit Profesional në Multimedia dhe Dizajn Grafik”

⁸⁰ Evidenca 42: Raporti vjetor Departamenti i Shkencave të Komunikimit 2019-2020, Aktivitetet ekstrakurrikulare

⁸¹ Evidenca 43: Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave të Komunikimit, viti akademik 2020-2021, Aktivitetet ekstrakurrikulare

⁸² Shtojca 1: Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E) (Tabela 9)

cilësor dhe për të nxitur mobilitetin e studentëve.	dhe jashtë Shqipërisë. Krahas ndërmjetësimit, Departamenti i Shkencave të Komunikimit ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione të fushës së marketingut, marrëdhënieve publike, medias dhe komunikimit, me qëllim realizimin e programit. Këto marrëveshje janë bërë bazë për organizimin e praktikave të studentëve, projekteve të përbashkëta dhe bashkëpunime të tjera në funksion të realizimit sa më mirë të aktivitetit të departamentit. ⁸³			
Kriteri 4. Në përfundim të çdo moduli apo lënde, personeli akademik vlerëson, analizon e shqyrton kompetencat dhe aftësitë e fituara nga studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, duke nxjerrë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orientojnë studentët për implementimin e tyre.	Në përfundim të semestrit, pedagogu i lëndës sigurohet me anë të mjeteve të tij vlerësuese që objektivat e shprehura në syllabuset e lëndëve, të jenë arritur dhe plotësuar. Kjo paraqitet edhe në anketën e vlerësimit që plotësohet nga ana e stafit akademik në mënyrë periodike, çdo vit. ⁸⁴ Këto trajtohen në diskutim të lirë me studentët ku secila prej palëve paraqet konkluzionet përkatëse për njohuritë dhe shprehitë e fituara duke nxjerrë dhe konkluzionet e nevojshme për nevojat e përmirësimit të vazhdueshëm të procesit. Gjithashtu studentët marrin udhëzime konkrete për format e implemetimit të njohurive dhe aftësive të fituara nëpërmjet praktikave profesionale në kompani apo institucione të ndryshme.			
Kriteri 5. Institucioni harton procedura të posaçme, të njohura e publike për diplomimin e studentëve dhe garanton mbështetjen dhe udhëzimin e studentëve në procesin e diplomimit. Ai mban regjistra zyrtarë të studentëve të diplomuar dhe i përditëson ata në fund të çdo viti akademik.	Procesi i diplomimit është objekt në fluksin e informacionit që merr çdo student që frekuenton programin profesional në “Multimedia dhe Dizajn Grafik” në KU “Bedër”. Ky proces është pjesë e Rregullores Themelore të institucionit, rregullores së studimeve dhe provimeve të ciklit të parë, rregullores së programit, ku saktësohen dhe detyrimet që duhet të përmbushë studenti deri në finalizimin e diplomimit të tij. ^{85 86 87}			
Kriteri 6. Njësia përgjegjëse, personeli akademik dhe udhëheqësit akademikë orientojnë dhe ndihmojnë studentët për përgatitjen e punimit të diplomës, realizimin e veprimtarisë praktike dhe përpunimit të rezultateve, duke garantuar bashkëpunimin edhe me aktorë të jashtëm për realizimin e saj.	Informacioni dhe udhëzimet mbi provimin final dhe mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve është i publikuar. Pedagogët përgjegjës plotësojnë një program lëndor (syllabus-et) për lëndën e provimit të përgjithshëm përfundimtar, si dhe për projektin e diplomimit dhe i shpërndajnë ato te studentët në fillim të semestrit. Udhëheqësit e temës së diplomës punojnë me studentët e caktuar përkatësisht në mënyrë të pavarur dhe ndajnë me to të gjitha materialet që mund t'i ndihmojnë ata të kryejnë punën e tyre kërkimore. Kolegji Universitar “Bedër” bën të mundur bërjen publike të informacioneve rreth provimeve finale ose mbrojtjes së diplomave sipas rregullores. Udhëheqësit e diplomave janë aktori kyç në përcjelljen dhe kontrollimin e këtij informacioni. ^{88 89}			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

⁸³ Evidenca 33: Marrëveshjet e bashkëpunimit (aktive) me organizata, institucione dhe aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj dhe për praktikën profesionale

⁸⁴ Evidenca 52: Anketa Vlerësuese nga Stafit Akademik ndaj institucionit

⁸⁵ Evidenca 7: Rregullorja e programeve të studimit të ciklit të parë, neni 15

⁸⁶ Evidenca 5: Rregullorja e “Programit Profesional në Multimedia dhe Dizajn Grafik”

⁸⁷ Evidenca 30: Manuali për përgatitjen e tezës së diplomës dhe kriteret e vlerësimit të tezës për studentët e ciklit të parë

⁸⁸ Evidenca 30: Manuali për përgatitjen e tezës së diplomës dhe kriteret e vlerësimit të tezës për studentët e ciklit të parë

⁸⁹ Evidenca 61: Vendim i këshillit të departamentit për ngarkesën mësimore

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT DHE MBËSHTETJA E STUDENTËVE

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për përzgjedhjen dhe cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efëcente dhe efektive nga ana e tyre	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton procedura dhe kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura, që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të tij.</p>	<p>Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit të personelit, në përputhje me statutin dhe rregulloren. Kjo procedurë parashikohet si në statutin e KU “Bedër”⁹⁰, po ashtu edhe në rregulloren themelore⁹¹ të institucionit dhe në procedurën e punësimit të personelit⁹².</p> <p>Siç parashikohet edhe në nenin 61 të Statutit, kriteret e punësimit të personelit akademik me kohë të plotë përcaktohen nga njësia bazë, bazuar në nevojat e kësaj të fundit, pas pëlqimit të Dekanit dhe miratimit nga Rektori. Përzgjedhja e kandidatit drejtohet nga një komision ad-hoc, i përbërë në shumicë nga njësia bazë përkatëse. Komisioni ad-hoc bën renditjen e kandidaturave, ia propozon Rektorit dhe ky i fundit bën emërimin me kohë të plotë të punonjësit.</p> <p>Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohet në përputhje me strategjinë për zhvillim të KU “Bedër” Stafi në institucion dhe konkretisht në Departamentin e Shkencave të Komunikimit është përzgjedhur, duke treguar një rëndësi të veçantë në fushën e tyre të specializimit, e që përputhet më së miri me zhvillimin e Institucionit dhe të departamentin gjithashtu.⁹³</p>

⁹⁰ Evidenca 2: Statuti i Kolegjit Universitar “Bedër”, Neni 61

⁹¹ Evidenca 3: Rregullorja themelore e Kolegjit Universitar “Bedër”, Neni 26

⁹² Evidenca 37: Procedura e punësimit të personelit

⁹³ Evidenca 37: Procedura e punësimit të personelit

<p>Kriteri 2. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program, personin përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, përfshirë tutorët apo vëzhguesit e praktikës në institucionet partnere, si dhe atë të personelit ndihmësmësor-shkencor dhe administrativ të angazhuar.</p>	<p>Zyra e burimeve njerëzore disponon një dosje të posaçme për çdo anëtar të personelit akademik dhe administrativ, të përditësuar sipas kuadrit ligjor në fuqi.⁹⁴</p> <p>Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit. Çdo fillim semestri, me propozim të njësisë bazë, aprovim të dekanatit dhe miratim të rektoratit përcaktohet ngarkesa mësimore për secilin anëtar të personelit akademik të çdo departamenti. Shembull i kësaj procedure mund të vërehet në Udhëzimin për ngarkesën mësimore.⁹⁵</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimit me karakter profesional dhe për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>KU “Bedër” ka një vendndodhje që disponon mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore. KU Bedër ka në sasi të mjaftueshme hapësirash, si: laboratorë, klasa, zyra, e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve.⁹⁶</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit, përmes organizimit të programeve specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, si dhe mbështetjen për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësor-shkencor.</p>	<p>Angazhimi i personelit aktual akademik ka synuar dhe arritur një punë optimale për përmbushjen e objektivave të programeve të ciklit të parë. Kjo realizohet si në aspektin e mësimdhënies e mësimnxënies brenda institucionit, ashtu edhe në drejtim të bashkëpunimeve me institucione dhe kompani të ndryshme për të siguruar realizimin e praktikave profesionale nga studentët e departamentit. Kjo mundëson zbatimin në praktikë të aspekteve teorike të programit, të cilat sigurojnë përvetësim dhe aftësim më të plotë si nga ana e aspekteve teorike dhe praktike.^{97 98}</p> <p>Angazhimi i këshilltarëve akademikë është një formë efektive për të orientuar studentët në përzgjedhjen e lëndëve në përputhje me programin e studimeve (si lëndët e detyrueshme, ashtu edhe ato me zgjedhje). Këshilltarët akademikë janë orientuesit e studentëve në faza të ndryshme gjatë zhvillimit të këtij programi studimesh në lidhje me kërkesat, rregulloret, kushtet e diplomimit si dhe për t’i këshilluar në lidhje me karrierën e tyre pas diplomimit.⁹⁹</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

⁹⁴ Evidenca 24: Lista e të dhënave të dosjes së stafit

⁹⁵ Evidenca 57: Udhëzim “Për ngarkesën mësimore”

⁹⁶ Shtojca 1: Mjediset e Fakultetit/Njësive Bazë (Tabela 16)

⁹⁷ Evidenca 61: Vendim i këshillit të departamentit për ngarkesën mësimore

⁹⁸ Shtojca 1: Ngarkesa totale e personelit akademik të programit profesional Multimedia dhe Dizajn Grafiku në një vit akademik (Tabela 4)

⁹⁹ Evidenca 62: Vendimi i këshillit të departamentit për caktimin e këshilltarëve akademik

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të përshtatshëm sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit me karakter profesional

Kriteret	Vlerësimi			
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Varësisht nevojave të programeve akademike, KU “Bedër” ofron mjediset që ndihmojnë studentin për formimin praktik dhe profesional. Të tilla janë newsroom, muzeu i medias dhe komunikimit, laboratorit i gjuhëve të huaja, laboratorit i kompjuterave, salla e gjyqit, klinika e ligjit etj. KU “Bedër” dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme hapësirash, si: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjediset të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve.			
Kriteri 2. Mjediset mësimore, si: klasat, laboratorët, studiot e mjediset e tjera janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Pajisjet e mjedisëve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit. Klasat janë të pajisura me mjetet e nevojshme teknologjike, si tabelë interaktive, projektorë, kompjuter, internet. Të gjitha mjediset mësimore, janë të pajisura me kondicionim dhe ndriçim të mjaftueshëm.			
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas fushës specifike të programit profesional, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Programet e ofruara nga KU Bedër nuk janë të natyrës teknike, për të cilat nevojiten laboratorë eksperimentimi. Për të përmbushur nevojat e programeve janë ngritur laboratorit i kompjuterave, redaksia, laboratorit i informatikës etj.			
Kriteri 4. Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/eve të studimit që ofron.	Siç u përmend edhe në kriterin e mësipërm, programet e ofruara nga KU “Bedër” nuk janë të natyrës teknike, për të cilat nevojiten laboratorë eksperimentimi. Departamenti i Shkencave të Komunikimit ka në dispozicion redaksinë e informacionit të portalit informativ www.objektiv.al .			
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale, internship-it dhe veprimtarive të tjera praktike thelbësore për programet me karakter profesional.	KU “Bedër”, veçanërisht Departamenti i Shkencave të Komunikimit, u kushton rëndësi të veçantë praktikave profesionale. Prandaj, gjatë vitit studentët nxiten dhe u ofrohet mundësia të ndjekin praktika profesionale. KU “Bedër” ndër vite ka nënshkruar një sërë marrëveshjesh me institucione të ndryshme mediatike, ku studentët gjatë periudhës së verës zhvillojnë këto praktika. ¹⁰⁰ Ndërkohë, KU “Bedër” ka ofruar mundësi praktikash profesionale edhe brenda institucionit, siç është zyra e marrëdhënies me publikun dhe median dhe portali Objektiv.al			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse e të posaçme të mësimnxënies, bibliotekën e literaturën dhe mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit dhe realizimin cilësor të tij

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit dhe krijon kushte për akses të barabartë e pa pagesë dhe të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	Literatura e nevojshme për lëndët e ofruara, bëhet e ditur me anë të programit të lëndës që në fillim të semestrit. Pedagogët e lëndëve kërkojnë nga departamenti që të sigurohen në bibliotekë të paktën disa kopje nga literatura e nevojshme. Biblioteka zotëron titujt kryesorë të përfshirë në literaturën e domosdoshme të çdo programi. ¹⁰¹
Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë mësimore bazë, ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, të mjaftueshme dhe të përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Biblioteka e KU “Bedër”, e cila është në dispozicion të studentëve çdo ditë të javës nga e hëna në të shtunë, ofron një gamë të gjerë titujsh, në total rreth 26 000. Këta tituj janë të përzgjedhur dhe klasifikuar në përputhshmëri me programet e studimit të ofruara nga KU “Bedër”, duke mbuluar nevojat e parashikuara sipas këtyre programeve të studimit.
Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit dhe duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	<p>Për të lehtësuar kërkimin shkencor të stafit akademik dhe të studentëve, Kolegji Universitar “Bedër”, ka bërë marrëveshje dhe ka akses të plotë si nga studentëve ashtu edhe nga ana stafit në JSTOR, një nga platformat më të mëdha akademike në botë. Studentët mund ta aksesojnë atë thjeshtë duke qenë të lidhur me internetin e KUB.¹⁰²</p> <p>KU “Bedër” parashikon fonde për blerjen e literaturës së specializuar në fushën e kërkimit shkencor, duke i akorduar çdo departamenti një fond të caktuar për pasurimin e bibliotekës me botimet dhe publikimet më të fundit të fushës.¹⁰³</p> <p>Pasurimi i bibliotekës është bërë gjithashtu edhe përmes një projekti studentor “Libri është i vetmi kopsht që mbillet për të tjerët”, i organizuar përmes një fushate sensibilizuese për mbledhjen e librave, nga studentët e Departamentit të Shkencave të Komunikimit, në kuadër të së cilës u mbledhën rreth 10 000 libra. Një pjesë e tyre u përdor për pasurimin e bibliotekës së institucionit, ndërsa pjesa tjetër u dhurua për shkolla, institucione të tjera dhe grupe në nevojë. Një nismë tjetër që ka kontribuar në pasurimin e bibliotekës së KU “Bedër”, ka qenë edhe dhurimi i 318 librave nga Ambasada Amerikane në Tiranë, gjatë muajit tetor 2018. Nga këta libra, 218 ishin botime specifike për Departamentin e Shkencave të Komunikimit.</p>
Kriteri 4. Institucioni, përmes bashkëpunimit me aktorë të jashtëm, të angazhuar në realizimin e programit mësimor, duhet t’u lehtësojnë dhe garantojë studentëve mbështetjen dhe përdorimin e burimeve e logjistikës së	KU “Bedër”, veçanërisht Departamenti i Shkencave të Komunikimit u kushton rëndësi të veçantë praktikave profesionale, sipas programeve përkatëse. KU “Bedër” ndër vite ka nënshkruar një sërë marrëveshjesh me institucione të ndryshme mediatike, ku studentët gjatë periudhës së verës zhvillojnë këto praktika. ^{104 105} Prandaj, gjatë verës dhe gjatë vitit akademik, studentët nxiten dhe u

¹⁰¹ Evidenca 58: Udhëzim mbi funksionimin e bibliotekës

¹⁰² Evidenca 31: Marrëveshja për akses në JSTOR

¹⁰³ Evidenca 14: Buxheti i Departamentit të Shkencave të Komunikimit

¹⁰⁴ Evidenca 42: Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave të Komunikimit, viti akademik 2019-2020, Listë e praktikave studentore

¹⁰⁵ Evidenca 43: Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave të Komunikimit, viti akademik 2020-2021, Listë e praktikave studentore

<p>nevojshme të institucioneve partnere, në varësi të natyrës së angazhimit të tyre në procesin formues teorik, praktik dhe profesional të studentëve.</p>	<p>ofrohet mundësia të ndjekin praktika profesionale pranë institucioneve, organizatave dhe bizneseve të ndryshme me të cilat departamenti dhe institucioni ka marrëveshje të ndryshme bashkëpunimi.^{106 107} Nërkohë, KU “Bedër” ka ofruar mundësi praktikash profesionale edhe brenda institucionit, siç është zyra e marrëdhënieve me publikun dhe median dhe portali Objektiv.al.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni parashikon koston financiare të programit të studimit profesional, mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi dhe raportin financiar të përvitshëm dhe në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi.</p>	<p>Çdo vit, fondacioni harton një raport ku parashikohen të ardhurat dhe shpenzimet e institucionit. Në raport paraqiten shpenzimet dhe të ardhurat që ka institucioni, të detajuara sipas llojit. Kolegji Universitar “Bedër” gëzon statusin e institucionit të lartë arsimor jofitimprurës. Një mbështetje e madhe financiare për institucionit janë donacionet. Institucioni siguron që të ketë të ardhura të mjaftueshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit.¹⁰⁸</p>			
<p>Kriteri 6. Financimi i një programi studimi profesional duhet të sigurojë e të garantojë mbulimin e të gjitha burimeve dhe veprimtarive të qëndrueshme dhe operative, të lidhura e që janë në funksion të realizimit të programit të studimit, duke garantuar njëkohësisht qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit e në vijim.</p>	<p>Në raportin financiar të institucionit paraqiten të gjitha të dhënat mbi shpenzimet dhe të ardhurat që ka Institucioni, të detajuara sipas llojit, burimit dhe destinacionit të tyre. Brenda raportit janë të specifikuar të gjitha zërat në lidhje me të ardhurat dhe të gjitha shpenzimet për shërbimet që ofron në mënyrë direkt apo indirekt. Në raport paraqiten të gjitha shpenzimet financiare, pagat e personelit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare etj. Raporti përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve. Kolegji Universitar “Bedër”, gëzon statusin e institucionit të lartë arsimor jofitimprurës. Duke vlerësuar veprimtarinë e deritanishme, KU “Bedër” dëshmon qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe bashkë me mbështetjen e donatorëve ka kapacitete të mjaftueshme financiare për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi IV.4 Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek, zbaton politika e procedura institucionale dhe i jep formacion të plotë e të hollësishëm studentëve mbi programin e studimit me karakter profesional, pranimin, përzgjedhjen, përparimin akademik, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni harton, zbaton dhe bën publike politika, procedura e kriteret të qarta e të kuptueshme për pranimit e studentëve, përparimin e tyre përgjatë kursit të studimit, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit, të cilat garantojnë</p>	<p>Pranimi i studentëve të rinj në programet e ciklit të parë që ofrohen nga KU “Bedër” bëhet në përputhje me ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. Politikat, procedurat dhe kriteret për pranimin dhe përparimin e studentëve janë të qarta dhe garantojnë barazi për të gjithë studentët pa</p>

¹⁰⁶ Evidenca 43: Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave të Komunikimit, viti akademik 2020-2021

¹⁰⁷ Evidenca 50: Shembull - Shkresë drejtuar një kompanie për realizimin e praktikave mësimore

¹⁰⁸ Shtojca 1: Të ardhurat dhe shpenzimet e ndryshme në 3 vitet e fundit (Tabela 18)

<p>barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>asnjë lloj diskriminimi. Nga ana tjetër, KU "Bedër" është përgjegjës për sigurimin e cilësisë në përgatitjen e studentëve, sipas standardeve dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të përgjithshme dhe/ose të veçanta për pranimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve në programet e studimit me karakter profesional dhe udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me to.</p>	<p>Kriteret për pranimin e studentëve në programet e studimit të ciklit të parë, për vitin akademik 2020-2021, janë si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Mesatarja e shkollës së mesme, për të gjitha vitet, në masën 70%. 2. Intervista nga komisioni i vlerësimit, i formuar nga departamenti përkatës, në masën 30%. <p>Kjo garanton barazinë në përzgjedhjen e kandidatëve për student në programet që KU "Bedër" ofron. Gjithashtu, KU "Bedër" ndjek politikë mbështetëse për të gjithë studentët dhe siguron ambiente dhe mjete të nevojshme për studentët me aftësi të kufizuara. Nga ana tjetër, KU "Bedër" ndjek politika mbështetëse për studentët me aftësi të veçanta, talente dhe që kanë fituar çmime, duke ofruar zbritje nga tarifa e studimit deri në 100% të saj.^{109 110 111}</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve, zhvillimin e veprimtarive praktike e profesionale të programit dhe institucionet bashkëpunuese në këto veprimtari, vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve dhe diplomimit.</p>	<p>Angazhimi i personelit aktual akademik ka synuar dhe ka arritur një punë optimale për përmbushjen e objektivave të programeve të ciklit të parë. Kjo realizohet si në aspektin e mësimdhënies e mësimnxënies brenda institucionit, ashtu edhe në drejtim të bashkëpunimeve me institucione dhe kompani të ndryshme për të siguruar realizimin e praktikave profesionale nga studentët e departamentit. Kjo mundëson zbatimin në praktikë të aspekteve teorike të programit, të cilat sigurojnë përvetësim dhe aftësim më të plotë si nga ana e aspekteve teorike dhe praktike.^{112 113}</p> <p>Angazhimi i këshilltarëve akademikë është një formë efektive për të orientuar studentët në përzgjedhjen e lëndëve në përputhje me programin e studimeve (si lëndët e detyrueshme, ashtu edhe ato me zgjedhje). Këshilltarët akademikë janë orientuesit e studentëve në faza të ndryshme gjatë zhvillimit të këtij programi studimesh në lidhje me kërkesat, rregulloret, kushtet e diplomimit si dhe për t'i këshilluar në lidhje me karrierën e tyre pas diplomimit.^{114 115}</p>
<p>Kriteri 4. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin, kohëzgjatjen e programit të studimeve, mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>KU Bedër në javën e parë të fillimit të vitit akademik sheh me rëndësi të veçantë "Ditët e orientimit". Përgjatë këtyre ditëve studentët njihen me stafin akademik dhe me atë administrativ, orarin, sistemin BIS, strukturën e KU Bedër, kohëzgjatjen dhe organizimin e programit.</p> <p>Po ashtu, institucioni nëpërmjet veprimtarive të orientimit dhe të kujdestarisë ndjek politika mbështetëse për studentët. Çdo grup i caktuar studentësh është nën përkujdesjen e një këshilltari akademik, i cili ndihmon në mbarëvajtjen e çështjeve mësimore. Kjo parashikohet në nenin 6 të rregullores për studimet e ciklit të parë dhe provimeve.¹¹⁶ Këto informacione dhe shumë të tjera publikohen si nga sistemi BIS, ashtu edhe nga faja zyrtare e KU "Bedër".¹¹⁷</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe udhëzues të</p>	<p>Siç u përmend edhe më sipër, i gjithë informacioni në lidhje me procesin mësimor ofrohet si nga sistemi BIS, ashtu edhe nga faja</p>

¹⁰⁹ Evidenca 7: Rregullorja e programeve të studimit të ciklit të parë

¹¹⁰ Evidenca 35: Praktika e ndjekur për miratim të kriterëve të pranimit të studentëve

¹¹¹ Evidenca 13: Rregullorja mbi zbritjet e tarifave të studimeve

¹¹² Evidenca 61: Vendim i këshillit të departamentit për ngarkesën mësimore

¹¹³ Shtojca 1: Ngarkesa totale e personelit akademik të Programit profesional Multimedia dhe Dizajn Grafik në një vit akademik (Tabela 4)

¹¹⁴ Evidenca 62: Vendimi i këshillit të departamentit për caktimin e këshilltarëve akademik

¹¹⁵ Evidenca 5: Rregullorja e "Programit Profesional në Multimedia dhe Dizajn Grafik", neni 6

¹¹⁶ Evidenca 7: Rregullorja e programeve të studimit të ciklit të parë

¹¹⁷ Linku i ndërfaqes së Programit profesional Multimedia dhe Dizajn Grafiku: <https://com.beder.edu.al/sh/content/default/programi-2-vjear-ne-multimedia-dhe-dizajn-grafik-12-15/354/661>

<p>posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen, veprimtaritë formuese dhe informacion të gjerë e të përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>zyrtare e KU “Bedër”. Në faqe gjendet Guida e Studentit, e cila prezantohet edhe në “Ditët e orientimit”, struktura dhe ngarkesa e programit të studimit, modulet dhe lëndët. Nga ana tjetër, nëpërmjet sistemit BIS studentët informohen për gjëra më specifike, lëndët përkatëse, informacione që mund të merren edhe pranë sekretarisë.^{118 119 120}</p>			
<p>Kriteri 6. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Me qëllim për të garantuar një komunikim sa më të shpejtë midis institucionit dhe studentit, KU “Bedër” ndjek politikë mbështetëse për studentët, nëpërmjet veprimtarive të orientimit dhe të kujdestarisë. Çdo grup i caktuar studentësh është nën përkujdesjen e një këshilltari akademik, i cili ndihmon në mbarëvajtjen e çështjeve mësimore. Përveç kësaj, sekretaria mësimore, në çdo kat bën afishimet e njoftimeve të ndryshme në tabelat e vendosura, bën njoftime edhe me anë të postës elektronike në adresat personale që kanë studentët të ofruara nga zyra e IT. Në momentin e nënshkrimit të kontratës, zyra e IT-së pajis me një adresë institucionale të gjithë studentët e regjistruar. Në lidhje me njoftimet për studentët e regjistruar, apo edhe për ata të rinj që shprehin interes, KU “Bedër” përdor faqen zyrtare të internetit, si edhe profilet në rrjetet sociale, si mjete të rëndësishme të komunikimit të jashtëm. Në këtë funksion, pranë KU “Bedër” shërben edhe zyra e protokollit dhe korrespondencës.</p> <p>Studentët e regjistruar në KU “Bedër” informohen në kohë reale kudo që ndodhen përmes sistemit BIS (Beder Information System), ku në ekranin e gjithsecilit shfaqet njoftimi përkatës. Ky komunikim mund të bëhet edhe nga distanca. Vetë sistemi BIS është i lidhur me Gmail në domanin @beder.edu.al, duke krijuar kështu një komunikim më efektiv. Komunikimi i brendshëm në KU “Bedër” kryhet nëpërmjet sekretarive të ngritura pranë njërive bazë dhe njërive kryesore. Personeli i institucionit ka një adresë elektronike të brendshme. Departamenti i IT-së pajis çdo anëtar të personelit me adresë poste elektronike të formës: shkronja e parë e emrit, mbiemri@beder.edu.al.^{121 122}</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi IV.5</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit me karakter profesional</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin e daljen në tregun e punës.</p>	<p>BIS është sistemi i automatizimit që përdoret në Kolegjin Universitar “Bedër”. Në faqen e menaxhimit të studenteve jepen informacionet kryesore në lidhje me studentin: ID, emri, mbiemri, programi, emali, data e regjistrimit, statusi i regjistrimit të lëndëve, transkripti.</p> <p>Te statusi i regjistrimit të lëndëve kemi 3 raste:</p> <p>1. Ngjyra e kuqe - tregon që studenti është larguar nga shkolla dhe nuk mund të regjistrohet.</p>

¹¹⁸ Linku i ndërfaqes së Programit profesional Multimedia dhe Dizajn Grafiku: <https://com.beder.edu.al/sh/content/default/programi-2-vjear-ne-multimedia-dhe-dizajn-grafik-12-15/354/661>

¹¹⁹ Evidenca: Guida e Studentit

¹²⁰ Evidenca 5: Rregullorja e “Programit Profesional në Multimedia dhe Dizajn Grafik”

¹²¹ Evidenca 18: Guida e Studentit

¹²² Aktivitet e Ditëve të Orientimit: <https://com.beder.edu.al/sh/news/activities/ditet-e-orientimit-departamenti-i-shkencave-ta-komunikimit/1568>

	<p>2. Ngjyra e verdhë - tregon që studenti ka probleme me dokumentet e sjella në sekretari ose probleme me pagesën e shkollës, kështu që nuk mund të kryejë regjistrimin e lëndëve.</p> <p>3. Ngjyra jeshile - tregon që studenti i ka kryer të gjitha procedurat dhe është i gatshëm të kryejë regjistrimin e lëndëve.</p> <p>Sekretaria mësimore bën gjithashtu shpërndarjen e orëve dhe emërimin e pedagogëve. Duhet theksuar që ky proces bëhet përpara hapjes së sistemit të regjistrimit të lëndëve për studentët. Në momentin që është kryer emërimi i pedagogëve dhe është bërë shpërndarja e orëve, atëherë mund të hapet sistemi i regjistrimit të lëndëve. Në rastin kur shtohen studentë të rinj, klikohet butoni jeshil që lexon "+ Add New Student". Butoni aktivizon një dritare të re, e cila gjithashtu ka disa fusha specifike për të plotësuar të dhënat e studentit të ri.¹²³</p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe të partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Sistemi BIS bën të mundur që të gjitha veprimtaritë në institucion të bëhen në mënyrë të automatizuar. Sipas sistemit BIS të gjitha njësitë kanë një llogari, faqe të tyre ku bëjnë veprimet në lidhje me detyrat përkatëse. Në BIS ka një llogari për secilën nga njësitë e mëposhtme: Llogari për studentët, stafin akademik, burimet njerëzore, sekretarinë e mësimore, bibliotekën, sekretarinë e departamentit, financën, menaxhimin e dokumenteve, menaxhimin e mbledhjeve, zyrën e pranimit, zyrën e programit të shkëmbimit.</p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Nga ana tjetër, të gjithë dokumentacionet që lidhen me procesin e mësimdhënies dorëzohen pranë sekretarive të departamenteve. Siç u tha edhe më sipër, sistemi BIS ofrohet me llogari për studentët, dhe me llogari për personelin. Me anë të këtij sistemi u sigurohet akses në të dhëna dhe informacione. Po ashtu, një pjesë e informacioneve dhe dokumenteve mund të merren pranë sekretarive.^{124 125 126}</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>KU "Bedër" ka realizuar integrimin në sistemin e menaxhimit të institucionit BIS të platformës Google për arsim. Kjo platformë mundëson komunikimin interaktiv dhe shkëmbimin e informacionit midis stafit dhe studentëve. Për këtë përdoruesit (personeli dhe studentët) janë të pajisur me një postë elektronike në domenin beder.edu.al që është një llogari në Google. Gjithashtu institucioni përdor platformën "G-Suite" për të aksesuar, koordinuar dhe organizuar materialet mësimore të lëndëve në Cloud.</p> <p>Sistemi BIS e mundëson komunikimin midis studentëve dhe personelit ku si shembull mund të përmendet komunikimi për procedurat mbi llogarinë e financës. Pasi studenti paraqet mandatin e pagesës pranë zyrës së financës, financa aprovon në sistem mandatin e pagesës nëpërmjet aprovimit të studentëve për të regjistruar lëndët në fillim të semestrit.¹²⁷</p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>Sistemi Informativ Bedër (BIS) është një sistem që lehtëson punën në institucionin Bedër. I kryen veprimet në një rrugë të automatizuar, duke shmangur kështu gabimet e mundshme dhe duke ndjekur të gjitha rregullat dhe procedurat që dalin nga Senati ose Rektorati.</p> <p>Në kontekstin e mësimin online, KUB përdor platformën One.beder.edu.al, e cila mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët, rreth mbarëvajtjes së procesit mësimor.</p>
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik</p>	<p>Në faqen zyrtare në internet të institucionit beder.edu.al informacionet të cilat lidhen me programet e studimit, personelin akademik dhe</p>

¹²³ Evidenca 60: Udhëzues i sistemit informativ (BIS)

¹²⁴ Evidenca 60: Udhëzues i sistemit informativ (BIS)


¹²⁵ Evidenca 18: Guida e Studentit


¹²⁶ Evidenca 17: Guida e Personelit

¹²⁷ Shtojca 1: Të dhëna të plota për platformat on-line/Struktura e teknologjisë së informacionit/ Biblioteka/ Biblioteka online, etj. (Tabela 17)

dhe aktivitetet e ndryshme publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.	aktivitetet e tjera të Kolegjit Universitar "Bedër" publikohen në faqen e internetit në dy gjuhë, ku njëra është gjuha angleze dhe gjuha tjetër është gjuha shqipe. Në këtë faqe publikohen edhe informacione të dedikuara njësisive kryesore e atyre bazë. Informacionet që lidhen me Departamentin e Shkencave të Komunikimit gjenden në adresën com.beder.edu.al			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X





V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
<p>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin, në programin e studimit dhe i vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit</p>	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika, procedura dhe kriteret të pranimit, përparimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit të studentëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore dhe që janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Pranimi i studentëve të rinj në programet e karakterit profesional që ofrohen nga KU “Bedër” bëhet në përputhje me ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.</p> <p>Po ashtu, KU “Bedër”, në kuadër të transparencës kundrejt studentëve dhe palëve të treta të interesuara jep në faqen e internetit gjithë informacionin e nevojshëm për përmbajtjen e programeve profesionale që ofron. Sa më sipër, njësitë bazë kanë faqet e tyre të internetit, të cilat mund të aksesohen si në mënyrë të drejtpërdrejtë, po ashtu edhe përmes faqeve të njësive kryesore, siç janë faqet e fakulteteve. Në këto faqe ka një paketë të gjerë transparence, në lidhje me programet e studimit që ofrohen, përfshirë këtu personelin akademik, kurrikulat, sylabuset e lëndëve, këshillat e departamenteve etj.</p> <p>Po ashtu, procedurat, përzgjedhjet e studentëve dhe njoftimet që lidhen me procesin e regjistrimit apo të transferimit të studimeve, bëhen në faqen zyrtare dhe në platforma që administrohen nga KU “Bedër”.^{128 129}</p> <p>Këto informacione mund të sigurohen edhe përmes sekretarive të departamentit dhe sekretarisë mësimore, ose pranë zyrës së pranimit.¹³⁰</p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje dhe orientimin drejt tregut të punës, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Institucioni garanton barazinë në përzgjedhjen e kandidatëve për student në programet që ofron. Nga ana tjetër KU “Bedër” ndjek politikë mbështetëse për të gjithë studentët dhe siguron ambiente dhe mjete të nevojshme për studentët me aftësi të kufizuara. Gjithashtu, KU “Bedër” ndjek politika mbështetëse për studentët me aftësi të veçanta, talente dhe që kanë fituar çmime, duke ofruar zbritje nga tarifa e studimit deri në 100% të saj.^{131 132 133}</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve dhe, përpara fillimit të çdo viti akademik, udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Procedurat e pranimit të studentëve për çdo vit akademik, si edhe kuotat për çdo program studimi, së bashku me kriteret e pranimit, i dërgohen ministrisë përkatëse, si edhe bëhen publike përmes faqes së internetit. Varësisht afateve të përcaktuara nga agjencitë shtetërore, KU “Bedër” mban lidhje të ngushta me drejtoritë arsimore rajonale dhe, përmes panairëve të karrierës në qytete dhe qendra të ndryshme të vendit. Përmes kësaj praktike, maturantët e këtyre shkollave njihen me ofertën akademike të KU Bedër.¹³⁴</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e</p>	<p>Siç u përmend edhe më sipër, KU “Bedër”, në kuadër të transparencës kundrejt studentëve dhe palëve të treta të interesuara, jep në faqen e internetit gjithë informacionin e nevojshëm për përmbajtjen e programeve</p>

¹²⁸ Evidenca 35: Praktika e ndjekur për miratim të kriterëve të pranimit të studentëve

¹²⁹ Evidenca 10: Rregullorja e transferimeve

¹³⁰ Shembull njoftimi <https://www.beder.edu.al/sh/news/other/lista-e-kandidateve-fitues-te-raundit-te-pare-viti-akademik-2020-2021/1591>

¹³¹ Evidenca 7: Rregullorja e programeve të studimit të ciklit të parë

¹³² Evidenca 35: Praktika e ndjekur për miratim të kriterëve të pranimit të studentëve

¹³³ Evidenca 13: Rregullorja mbi zbritjet e tarifave të studimeve

¹³⁴ Evidenca 35: Praktika e ndjekur për miratim të kriterëve të pranimit të studentëve

përparimit akademik të studentëve, kalimit nga një vit akademik në tjetrin, procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	<p>profesionale që ofron.</p> <p>Po ashtu, procedurat, përzgjedhjet e studentëve dhe njoftime që lidhen me procesin e regjistrimit apo të transferimit të studimeve, bëhen në faqen zyrtare dhe në platforma që administrohen nga KU Bedër.¹³⁵</p> <p>Të gjitha këto informacione janë të aksesueshme edhe për publikun me anë të faqes së internetit, si edhe me Guidën e Studentit.¹³⁶ Këto informacione mund të merren nga studentë edhe pranë sekretarisë së Departamentit, pranë sekretarisë mësimore si edhe nëpërmjet këshilltarit akademik dhe zyrës së pranimit.¹³⁷</p>			
Kriteri 5. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit dhe diplomimit në programin e studimit.	<p>KU “Bedër” në javën e parë të fillimit të viti akademik sheh me rëndësi të veçantë “Ditët e orientimi”. Përgjatë këtyre ditëve studentët njihen me stafin akademik dhe me atë administrative, orari, sistemin BIS, strukturën e KU “Bedër”, kohëzgjatjen dhe organizimin e programit si dhe mënyrat e vlerësimit të dijeve.</p> <p>Po ashtu, institucioni nëpërmjet veprimtarive të orientimit dhe të këshillimit ndjek politika mbështetëse për studentët. Çdo grup i caktuar studentësh është nën përkujdesjen e një këshilltari akademik, i cili ndihmon në mbarëvajtjen e çështjeve mësimore. Kjo parashikohet në nenin 6 të rregullores për studimet e ciklit të parë dhe provimeve.¹³⁸</p> <p>Këto informacione dhe shumë të tjera publikohen si nga sistemi BIS, ashtu edhe nga faqja zyrtare e KU “Bedër”.¹³⁹</p>			
Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	<p>KU “Bedër” është një institucion që ka kriteret në pranimin e studentëve dhe ka synuar angazhimin maksimal të personelit akademik ndaj studentit, duke respektuar të gjitha kriteret e kërkuara në këtë drejtim. Përmes faqes së internetit, broshurave, takimeve të drejtpërdrejta, panairëve të arsimit dhe karrierës, broshurave dhe pamfleteve etj., KU “Bedër” bën publike ofertën vjetore të programeve që ofron.</p>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënies dhe mundësitë e punësimit	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni informon në mënyrë të hollësishme studentët për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve dhe ve në dispozicion të tyre, informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit me karakter profesional.	<p>Të gjithë studentët informohen në lidhje me strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e studimeve që javën e parë të vitit akademik sin ë programin e orientimit dhe me anë të guidës së studentit. Në çdo syllabus, i cili është publik në faqen e departamentit gjenden edhe kriteret apo zërat e vlerësimit, gjë e cila ju bëhet e ditur studentëve që në javën e parë të prezantimit të lëndës. Po ashtu, edhe në sistemin BIS, këto zëra vlerësimi ofrohen në kohë reale.¹⁴⁰</p> <p>Më tej, po në sistemin BIS, gjendet ecuria dhe vazhdimësia, jo vetëm e një lënde e gjithë periudhës së studimeve, nota dhe pikët e secilës lëndë;</p>

¹³⁵ Evidenca 10: Rregullorja e transferimeve

¹³⁶ Evidenca 18: Guida e Studentit

¹³⁷ Shembull njoftimi <https://www.beder.edu.al/sh/news/other/lista-e-kandidateve-fitues-te-raundit-te-pare-viti-akademik-2020-2021/1591>

¹³⁸ Evidenca 7: Rregullorja e programeve të studimit të ciklit të parë

¹³⁹ Linku i ndërfaqes së Programit Profesional në Multimedia dhe Dizajn Grafik <https://com.beder.edu.al/sh/content/default/programi-2-vjejar-ne-multimedia-dhe-dizajn-grafik-12-15/354/661>

¹⁴⁰ Evidenca 55: Shembull Syllabusi

	notat dhe pikët e grumbulluara, pjesëmarrja në leksione dhe seminare, si edhe mesatarja e gjeneruar nga sistemi. ^{141 142 143}			
Kriteri 2. Institucioni informon studentët mbi praktikat profesionale në kuadër të realizimit të programit të studimit, partnerët dhe institucionet bashkëpunuese ku parashikohen të realizohen, si dhe mundësitë e punësimit e mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.	Për të ndihmuar studentët në orientimin dhe këshillimin e karrierës, KU “Bedër” ka ngritur zyrën e planifikimit të karrierës, e cila funksionon pranë dekanatit të studentëve. Në këtë zyrë, çdo departament emëron një këshilltar për planifikimin e karrierës, i cili ofron konsulencë për studentët e regjistruar. Këshilltari i karrierës informon studentët me email mbi organizimin e seminareve, rreth teknikave të kërkimit të punës, të shkrimit të CV-së dhe kalimit me sukses të intervistës paraprake; kërkon mundësitë e punësimit për të gjithë studentët e diplomuar në programet me karakter profesional, programet “Bachelor” dhe “Master i shkencave”, organizon aktivitete të cilat synojnë ruajtjen e marrëdhënieve mes studentëve edhe pas diplomimit të tyre etj. ^{144 145 146}			
Kriteri 3. Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Ditët e orientimit – secila zyrë realizon prezantimin e saj dhe informon studentët zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën, laboratorët dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. Literatura e nevojshme për lëndët e ofruara, bëhet e ditur me anë të programit të lëndës që në fillim të semestrit. ¹⁴⁷			
Kriteri 4. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Me qëllim për të garantuar një komunikim sa më të shpejtë midis institucionit dhe studentit, KU “Bedër” ndjek politikë mbështetëse për studentët, nëpërmjet veprimtarive të orientimit dhe të kujdestarisë. Çdo grup i caktuar studentësh është nën përkujdesjen e një këshilltari akademik, i cili ndihmon në mbarëvajtjen e çështjeve mësimore. Përveç kësaj, sekretaria mësimore, në çdo kat bën afishimet e njoftimeve të ndryshme në tabelat e vendosura, bën njoftime edhe me anë të postës elektronike në adresat personale që kanë studentët të ofruara nga zyra e IT. Në momentin e nënshkrimit të kontratës, zyra e IT-së pajis me një adresë institucionale të gjithë studentët e regjistruar. Në lidhje me njoftimet për studentët e regjistruar, apo edhe për ata të rinj që shprehin interes, përdoret faqen zyrtare të internetit, si edhe profilet në rrjetet sociale, si mjete të rëndësishme të komunikimit të jashtëm. Studentët e regjistruar informohen në kohë reale kudo që ndodhen përmes sistemit BIS (Beder Information System), ku në ekranin e gjithsecilit shfaqet njoftimi përkatës. Ky komunikimi mund të bëhet edhe nga distanca. Vetë sistemi BIS është i lidhur me Gmail në domenin @beder.edu.al, duke krijuar kështu një komunikim më efektiv. Komunikimi i brendshëm në institucion kryhet nëpërmjet sekretarive të ngritura pranë njësive bazë dhe njësive kryesore. Personeli i institucionit ka një adresë elektronike të brendshme. Departamenti i IT-së pajis çdo anëtar të personelit me adresë poste elektronike të formës: Shkronja e parë e emrit, mbiemri@beder.edu.al. ^{148 149}			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

¹⁴¹ Link i një lënde nga faqja e Departamentit: <https://com.beder.edu.al/sh/content/default/bachelor-ne-shkenca-komunikimi-6-1/354/355/?con=0&cid=5318&t=1&oid=0>

¹⁴² Shtojca 1: Format e kontrollit të njohurive (Tabela 15)

¹⁴³ Evidenca 18: Guida e Studentit

¹⁴⁴ Evidenca 43: Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave të Komunikimit, viti akademik 2020-2021, Listë praktikash studentore

¹⁴⁵ Evidenca 42: Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave të Komunikimit, viti akademik 2019-2020, Listë praktikash studentore

¹⁴⁶ Evidenca 9: Vendimi i këshillit të departamentit për përcakimin e përfaqëuesit të karrierës

¹⁴⁷ Evidenca 40: Programi i ditëve të orientimit

¹⁴⁸ Evidenca 18: Guida e Studentit

¹⁴⁹ Aktivitetet e Ditëve të Orientimit: <https://www.facebook.com/BEDERUNIVERSITY/photos/pcb.5166002140081056/5166002143414479/>

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit me karakter profesional, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në vitet paraardhëse në programin e studimit.</p>	<p>Zyra e sekretarisë mësimore ndjek nga afër regjistrimin e të gjithë studentëve, duke krijuar dosjen individuale për secilin prej tyre dhe raporton në mënyrë periodike në fund të çdo semestri statistikën e studentëve të çdo programi.¹⁵⁰ Nga ana tjetër, zyra e sekretarisë mësimore, ndër funksionet e saj ka edhe përpunimin e të dhënave në formë statistikore të të diplomuarve. Kjo parashikohet në rregulloren e zyrës së sekretarisë mësimore, neni 3 i saj.^{151 152}</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon dhe ruan statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Zyra e sekretarisë mësimore disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve dhe i raporton këto statistika te instancat përkatëse. Institucioni siguron informacion në kohë reale përmes sistemit BIS, si dhe nëpërmjet sekretarive të ngritura pranë njësive bazë dhe njësive kryesore.^{153 154 155}</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre, përfshirë punësimin eventual të tyre.</p>	<p>Të gjitha rezultatet e vlerësimit të studentëve në çdo lëndë nëpërmjet sekretarisë së departamentit i kalojnë zyrës së sekretarisë mësimore, e cila i arkivon ato.</p> <p>Këshilltari akademik – në llogarinë e tij në sistemin BIS ka informacione të detajuara në lidhje me mbarëvajtjen akademike për secilin nga studentët që ai këshillon. Këto të dhëna përfshijnë rezultatet e studentëve për të gjitha lëndët që studenti ka frekuentuar gjatë viteve të tij të eksperiencës akademike që nga pranimi në KU “Bedër” e deri në diplomim.¹⁵⁶</p> <p>Këto të dhëna disponohen edhe nga sekretaria mësimore. Çdo notë e studentëve regjistrohet në kopje fizike dhe kopje elektronike në sistem duke gjeneruar informacion të qartë mbi ecurinë e studentëve dhe performancën e tyre. Për secilin student sistemi llogarit mesataren semestrale dhe mesataren kumulative, e cila jep informacion të plotë dhe të detajuar mbi rezultatet pozitive dhe negative të studentëve. Këto informacione të hollësishme ndihmojnë në vendime të ndryshme që lidhen me nevojën e përsëritjes së lëndëve me qëllim përmirësimi të notes si dhe me diplomimin e studentëve.</p> <p>Zyra e sekretarisë mësimore është përgjegjëse për rregullimin, monitorimin dhe arkivimin e çdo regjistrimi, informacioni, dokumenti ose transkripti lidhur me studentët.</p> <p>Zyra e sekretarisë mësimore, midis detyrave të tjera që kryen, hedh, administron dhe ruan të dhënat e studentëve dhe të procesit mësimor në regjistra bazë, regjistrat e notave, të diplomimit dhe në çdo regjistër tjetër të parashikuar nga dispozitat ligjore në fuqi. Gjithashtu, hap dhe mirëmban dokument elektronik personal për çdo student, ku paraqiten</p>

¹⁵⁰ Evidenca 19: Gjurmimi i të Diplomuarve

¹⁵¹ Evidenca 8: Rregullorja e sekretarisë mësimore

¹⁵² Evidenca 4: Rregullorja mbi Organizimin Administrativ

¹⁵³ Evidenca 8: Rregullorja e sekretarisë mësimore

¹⁵⁴ Evidenca 43: Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave të Komunikimit, viti akademik 2020-2021

¹⁵⁵ Shtojca 1: Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve (Tabela 21)

¹⁵⁶ Evidenca 5: Rregullorja e “Programit Profesional në Multimedia dhe Dizajn Grafik” neni 6

	rezultatet e provimit të pranimit në IAL, lëndët e marra në çdo semestër gjatë periudhës së studimeve, bursat dhe masat disiplinore, si dhe t'i ruajë ato gjatë viteve. ¹⁵⁷			
Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Siç u përmend më sipër, zyra e sekretarisë mësimore ndjek nga afër regjistrimin e të gjithë studentëve, duke krijuar dosjen individuale për secilin prej tyre. Kjo zyrë kryen analiza dhe nxjerr të gjitha të dhënat statistikore. Këto të dhëna gjenerohen nga sistemi BIS, i cili aksesohet nga këshilltari akademik dhe sekretaria mësimore ¹⁵⁸			
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe të shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	<p>Në çdo fund viti, çdo njësi bazë përgatit raportin vjetor ku analizohet dhe diskutohet veprimtaria vjetore e njësisë, si edhe diskutohen masat në lidhje me përmirësimin e treguesve. Në këto raporte janë të përfshirë edhe cilësia në hyrje dhe dalje e studentëve, si dhe shkalla e punësimit të tyre.</p> <p>Në funksion të përmirësimit të këtyre treguesve çdo vit, institucioni përgatit oferta të ndryshme akademike për studentët me qëllim rritjen e cilësisë, si edhe lidh marrëveshje me bashkëpunëtorë të fushës.</p> <p>Në kuadër të planifikimit të karrierës, krahas zyrës së planifikimit të karrierës, pranë çdo departamenti është ngritur bordi i këshillimit të karrierës, në përbërje të të cilit janë shtatë anëtarë profesionistë, aktivë në profesionin e tyre. Ky bord u mundëson studentëve lidhjet e tyre me tregun e punës.</p> <p>Gjithashtu, në nivel departamenti ka pasur një sërë aktivitetesh të cilat u vijnë në ndihmë studentëve për të krijuar sa më shumë lidhje me tregun. Përmendim këtu serinë e leksioneve të hapura “Studenti dhe profesioni” dhe “Seminaret MarCOM” etj. ¹⁵⁹</p> <p>Nga ana tjetër, çdo grup studentësh ka një këshilltar akademik, të përcaktuar nga njësia bazë në çdo fillim viti akademik.</p> <p>Këshilltari ndjek dhe udhëzon studentin mbi anën akademike, gjatë periudhës studimore. Këshilltari miraton formularët e regjistrimit semestral për çdo student përkatës.</p>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	<p>Sipas ligjit të arsimit të lartë studentët janë të përfshirë në Senat, NJSBC, Komisionin e Përhershëm të Garantimit të Cilësisë.</p> <p>KU “Bedër”, me vendim Senati gjithashtu ka vendosur që studentët janë të përfshirë në këshill departamenti dhe këshill fakulteti.¹⁶⁰</p> <p>Për të garantuar përfshirjen dhe përfaqësimin e studentëve në organet vendimmarrëse në KU “Bedër” është ngritur Dekanati i Studentëve, si cili është përgjegjës për mbarëvajtjen e marrëdhënieve të studentëve me institucionin. Dekanati i Studentëve është përgjegjës për përdorimin sa më me efikasitet të burimeve të institucionit dhe për menaxhimin e</p>

¹⁵⁷ Evidenca 8: Rregullorja e sekretarisë mësimore, neni 3

¹⁵⁸ Evidenca 5: Rregullorja e “Programit Profesional në Multimedia dhe Dizajn Grafik” neni 6

¹⁵⁹ Seminaret MarCom, shembull: <https://www.beder.edu.al/sh/news/activities/komunikimi-qe-sjell-zhvillim-19/1692>

¹⁶⁰ Evidenca 38: Procesverbal mbledhje departamenti, ku është trajtuar një temë e sjellë nga studentet dhe ku kanë qenë prezent përfaqësues të studentëve

	<p>marrëdhënieve të sipërpërmendura, në përputhje me parimin “Studenti në qendër të universitetit”. Dekanati i Studentëve i kryen detyrat e tij në bashkëpunim me rektorin ose zëvendësrektorin. Kjo instancë i kushton rëndësi të veçantë kujdesit ndaj studentëve, duke pasur si mision kryesor orientimin, këshillimin dhe mbrojtjen e të drejtave të studentëve me anën e zyrave përkatëse.¹⁶¹</p> <p>Një rol të veçantë në këtë aspekt, luan edhe presidenti i këshillit studentor. Mbështetja nga Dekanati i Studentëve fillon që nga momenti i aplikimit të studentit dhe vazhdon edhe pas diplomimit, duke ruajtur një marrëdhënie produktive dhe mbështetëse si për studentin, ashtu edhe për institucionin. Gjithashtu, Dekanati i Studentëve organizon dhe mbështet studentët në praktikat profesionale, aktivitete sociale, projekte të ndryshme, si dhe në gjetjen e mundësive të ndryshme të punësimit.¹⁶²</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose e përfaqësuesve të tyre në vendimarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Në Kolegjin Universitar “Bedër” pjesëmarrja e studentëve në vendimarrje garantohet me përfaqësimin e tyre në Senatin Akademik, në NJSBC, në Komisionin e Përhershëm për Garantimin e Standardeve dhe Cilësisë, si dhe në mbledhjet e njësisë bazë.</p> <p>Vlerësimi i metodave të mësimdhënies është pjesë e rezultateve të mbledhura nga anketat me studentët për çdo lëndë dhe pedagog. Varësisht këtyre rezultateve, departamenti merr masa për përmirësimin e mëtejshëm të këtyre metodave të mësimdhënies. Anketimet me studentët zhvillohen dy herë në vit, para provimeve finale të çdo semestri.^{163 164}</p>
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Vlerësimi sasior i punës së studentëve në KU “Bedër” kryhet me anë të krediteve sipas sistemit amerikan dhe atij europian, të mbështetur në ECTS, kurse vlerësimi cilësor i punës së studentëve kryhet me anë të notave, të llogaritura sipas metodologjisë së përmendur në rregulloret mësimore.</p> <p>Përsa i përket ngarkesës, sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek programin profesional “Multimedia dhe Dizajn Grafik” me kohë të plotë është 60. Kjo vërtetohet edhe nga programet e licencuara nga MAS dhe të shprehura në kurrikulën e programit, si edhe në Statutin e KU “Bedër”.</p> <p>KU “Bedër” lejon transferimin e studentëve në vitet ndërmjetës nga IAL-të vendase ose të huaja, publike ose private, dhe anasjellas, si edhe brenda programeve të studimeve që ai ofron. Ky proces bëhet pas një barasvlerësimi sipas planeve mësimore përkatës. Transferimi lejohet ndërmjet programeve të të njëjtit cikël studimesh.^{165 166}</p> <p>KU “Bedër” ofron mundësi për transferime të studimeve midis programeve të të gjitha cikleve brenda institucionit apo nga/drejt institucioneve të ndryshme të arsimit të lartë.</p> <p>Vendimi për njohjen e plotë ose të pjesshme të krediteve të grumbulluara nga një student, me qëllim vazhdimin e studimeve, i takon strukturës mësimore që pranon studentin.</p> <p>Kriteret kryesore për njohjen e plotë të krediteve të grumbulluara nga një student janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> a) Njeshmëria e programit të studimit; b) Koha e kryerjes së studimeve. <p>Një komision ad-hoc me tre anëtarë që ngrihet nga këshilli i</p>

¹⁶¹ Evidenca 63: Vendimi i senatit për përfshirjen e studentëve në këshillin e departamentit dhe në këshillat e fakulteteve

¹⁶² Evidenca 64: Zgjedhjet e Këshillit Studentor

¹⁶³ Evidenca 53: Anketa vlerësuese për lëndën dhe pedagogun nga studentët

¹⁶⁴ Evidenca 38: Procesverbal mbledhje departamenti, ku është trajtuar një temë e sjellë nga studentet dhe ku kanë qenë prezent përfaqësues të studentëve

¹⁶⁵ Evidenca 7: Rregullorja e programeve të studimit të ciklit të parë

¹⁶⁶ Shtojca 1: Ngarkesa totale në auditor e studentëve për Format e mësimdhënies në programin e studimit, për secilin program (Tabela 13)

	<p>departamentit, vendos për transferimet që kryhen në programet e KU Bedër. Ky këshill kryen të gjitha procedurat përkatëse të ekuivalentimit të lëndëve për programet e ciklit të parë, duke i shoqëruar me një argumentim mbi kushtet e pranimit. Në përputhje me këtë, studentët të cilët kanë kryer procedurat e ekuivalentimit, pajisen me diplomë vetëm në rast se kanë ndjekur jo më pak se dy semestra studime pranë KU Bedër. Mënyra e transferimit në programet e ofruara në KU Bedër parashikohet në rregulloret mësimore të KU Bedër.¹⁶⁷</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Në faqen e çdo departamenti janë të publikuara të gjitha syllabuset e viteve të kaluara, gjë e cila është e aksesueshme nga publiku, si dhe nga studentët. Në këtë kuptim, ata mund ta krahasojnë syllabusin aktual me atë të viteve të kaluara dhe të konsultojnë atë me studentët përgjatë diskutimit dhe prezantimi të lëndës.</p> <p>Studentët janë të përfshirë në grupet e punës për riorganizimin dhe/ose hapjen e programeve akademike.</p> <p>KU Bedër i ka kushtuar një rëndësi të veçantë proceseve të ndryshme vetëvlerësuese, qofshin këto në lidhje me aspektin administrativ të institucionit, po aq edhe me aspektin akademik. Çdo fund viti, njësitë bazë dhe kryesore përgatisin raportin vjetor të cilin e dërgojnë në rektorat. Në këto raporte, përveç pasqyrimin të aktiviteteve, rëndësi i kushtohet edhe analizës SWOT</p>			
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Anketimet e studentëve për personelin akademik, për të cilat u fol më sipër, plotësohen përmes sistemit online të informimit (Beder Information System - BIS), para zhvillimit të provimeve finale në çdo fund semestri. Plotësimi i pyetësorëve është anonim dhe përgjigjet përpunohen në mënyrë automatike dhe të pavarur. Pas sigurimit të të dhënave vlerësuese për personelin akademik, në fund të çdo semestri akademik bëhet edhe vlerësimi për secilin anëtar të personelit akademik, rezultati i të cilit dorëzohet nëpërmjet një zarfi të mbyllur.¹⁶⁸</p> <p>Po ashtu, në rast kontestimi të notës, studentët mund kërkojnë rivlerësim të provimit me anë të një kërkesë në sekretarinë e departamentit.^{169 170}</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi V.5

Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>KU “Bedër” dhe Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë, si njësi e saj kryesore, në kuadër të transparencës kundrejt studentëve dhe palëve të treta të interesuara jep në faqen e internetit gjithë informacionin e nevojshëm për përmbajtjen e programeve “Bachelor” që ofron.</p> <p>Pra, informacionet bazë studentët i marrin nga faqja zyrtare e institucionit e cila është vazhdimisht e përditësuar. Po kështu edhe</p>

¹⁶⁷ Evidenca 10: Rregullorja e transferimeve

¹⁶⁸ Evidenca 54: Anketë vlerësimi e mendimit të studentëve ndaj institucionit

¹⁶⁹ Evidenca 53: Anketa vlerësuese për lëndën dhe pedagogun nga studentët

¹⁷⁰ Evidenca 36: Praktikë ankimim note

	<p>zyrat përkatëse brenda institucionit informojnë në mënyrë të vazhdueshme studentët dhe u ofrojnë atyre të gjitha shërbimet e kërkuara. Kështu zyra e regjistrimit, këshilltari akademik, dekani i studentëve, sekretaria mësimore, zyra e planifikimit të karrierës e studentëve të diplomuar etj., janë në funksion të informimit e ofrimit të shërbimeve për studentët.</p> <p>Gjithashtu, studentët pajisen me syllabusin përkatës nga çdo lektor në fillim të semestrit.</p> <p>Studentët gjatë gjithë periudhës, janë në kontakt të vazhdueshëm me këshilltarin akademik. Po ashtu, janë vazhdimisht të informuar rreth performancës së tyre akademike nëpërmjet sistemit të informimit të brendshëm BIS dhe emaileve që marrin nga zyrat e përmendura më lart.^{171 172 173}</p>
<p>Kriteri 2. Në institucion është ngritur dhe funksionon një sistem i posaçëm për mirëpritjen, informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe ndihmesën e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Ky sistem funksionon nëpërmjet Këshilltarit Akademik dhe Këshilltarit të Karrierës së ngritur pranë njësive bazë. Nëpërmjet tyre, studentët informohen, këshillohen, asistohen për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit, si dhe për çështje që lidhen me praktikën apo me programe ekstrakurrikulare ^{174 175 176}</p>
<p>Kriteri 3. Përmes zyrës/njesisë për këshillimin e karrierës, institucioni mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm lidhur me plotësimin e detyrimeve të procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Për të ndihmuar studentët në orientimin dhe këshillimin e karrierës, KU Bedër ka ngritur zyrën e planifikimit të karrierës, e cila funksionon pranë Drejtorisë së Marrëdhënive me Studentin. Pranë kësaj zyre, çdo departament emëron një këshilltar për planifikimin e karrierës, i cili ofron konsulencë për studentët e regjistruar. ¹⁷⁷</p> <p>Këshilltari i karrierës informon studentët mbi organizimin e seminareve, rreth teknikave të kërkimit të punës, të shkrimit të CV-së dhe kalimit me sukses të intervistës paraprake; kërkon mundësi punësimi për të gjithë studentët e diplomuar në programet “Profesionale”, “Bachelor” dhe “Master”, organizon aktivitete që synojnë ruajtjen e marrëdhënive mes studentëve edhe pas diplomimit të tyre etj.</p> <p>Një rol i rëndësishëm i kësaj zyre është mundësimi i praktikave profesionale për studentët e të gjithë departamenteve që ofron KU Bedër. ¹⁷⁸</p>
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit, ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse dhe merr masa për përmirësimin e shkallës dhe cilësisë së punësimit të tyre.</p>	<p>Zyra e karrierës dhe zyra e të diplomuarve përgatisin raporte periodike në lidhje me punësimin e studentëve, trajnimin e tyre, dhe mundësi që ofron tregu, dhe ua paraqesin ato studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p> <p>KU “Bedër” në strukturën organizative ka ngritur zyrën e të diplomuarve, e cila funksionon në varësi të Dekatit të Studentëve. Kjo zyrë mban të dhëna në lidhje me të diplomuarit, punësimin e tyre, etj. ^{179 180}</p> <p>Meqenëse në programin “Multimedia dhe Dizajn Grafik” nuk ka ende të diplomuar ky kriter nuk i aplikueshëm.</p>

¹⁷¹ Evidenca 5: Rregullorja e “Programit Profesional në Multimedia dhe Dizajn Grafik”, neni 6

¹⁷² Evidenca 8: Rregullorja e sekretarisë mësimore

¹⁷³ Evidenca 4: Rregullorja mbi Organizimin Administrativ

¹⁷⁴ Evidenca 5: Rregullorja e “Programit Profesional në Multimedia dhe Dizajn Grafik”, neni 6

¹⁷⁵ Evidenca 9: Vendimi i këshillit të departamentit për përcaktimin e përfaqësuesit të karrierës

¹⁷⁶ Evidenca 23: Lista e praktikave profesionale të studentëve

¹⁷⁷ Evidenca 9: Vendimi i këshillit të departamentit për përcaktimin e përfaqësuesit të karrierës

¹⁷⁸ Evidenca 43: Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave të Komunikimit, viti akademik 2020-2021, Listë praktikash studentore

¹⁷⁹ Evidenca 19: Gjurmimi i të Diplomuarve

¹⁸⁰ Evidenca 4: Rregullorja mbi Organizimin Administrativ

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

C. PËRFUNDIME TË VLERËSIMIT TË PROGRAMIT TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL “MULTIMEDIA DHE DIZAJN GRAFIK” TË INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË “KOLEGJI UNIVERISTAR BEDËR”

Pikat e forta dhe afirmime

1. Cilësia e personelit akademik. Personeli akademik efektiv i angazhuar në realizimin e programit të studimit e profesional në “Multimedia dhe Dizajn Grafik”, ka nivel të lartë të përgatitjes profesionale dhe eksperiencë të gjatë në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor në profilin përkatës.
2. Infrastruktura në dispozicion të programit është e plotë dhe bashkëkohore. Studentët e programit profesional në multimedia dhe dizajn grafik kanë në dispozicion dy laboratorë dhe një atelie, të pajisur me teknologjinë më bashkëkohore.
3. Një departament i konsoliduar në ofertën akademike, me dy programe bachelor në fushën e komunikimit, gazetarisë dhe marrëdhënieve me publikun, shërben si mbështetje për ecurinë e një programi profesional në këto fusha.
4. Personeli me kohë të pjesshme dhe lektorët e ftuar që vijnë nga institucione të ndryshme, si ato të medias, marrëdhënie me publikun, artit, dizajnit dhe marketingut, sjellin në auditor një qasje praktike, duke i orientuar më mirë studentët drejt përvetësimit të kompetencave profesionale.
5. Angazhimi i këshilltarëve akademikë, garanton mbështetje si për sa i përket ecurisë akademike, ashtu edhe orientimit dhe përshtatjes me nevojat e tregut të punës.
6. Grupe të vogla studentësh për vit akademik. Politika e kuotave jomasive ka sjellë një impakt pozitiv në cilësinë e studentëve të pranuar dhe të diplomuar nga programi. Grupet e vogla që nuk e kalojnë numrin 20 studentë, i japin mundësi personelit akademik dhe mbështetës në departament, për një angazhim të personalizuar ndaj çdo studenti.
7. Mundësitë për bursa studimi sociale, por edhe tarifat jo të larta të studimit në raport me IAL-të e tjera jo publike, u jep mundësi për të studiuar edhe grupeve të marginalizuara si pasojë e kushteve të vështira ekonomike, jetimëve, të rinjve me aftësi ndryshe etj.
8. Sistemi i automatizimit (BIS) lehtëson aktivitetin mësimdhënës dhe mësimnxënës. Sistemi i automatizimit krijon mundësi për të realizuar leksione, projekte, aktivitete mjaft kreative, duke përdorur multimedian dhe aplikuar interaktivitetin, si një element shumë i rëndësishëm për të rritur aftësitë perceptuese dhe përvetësuese të studentët.
9. Përfshirja e institucionalizuar e studentëve në këshillin e departamentit dhe dëgjimi i zërit të tyre në proceset vendimmarrëse të departamentit.
10. Gërshetimi harmonik mes aspektit teorik dhe atij praktik gjatë realizimit të programit të studimit. Për nga vetë natyra e programit, është e rëndësishme që studentët të marrin në mënyrë të koordinuar dijet teorike dhe praktike që parashikohen në kurrikul.

11. Auditorë të hapur për përfaqësues të njohur të institucioneve, organizatave dhe kompanive të ndryshme shqiptare e të huaja. Larmishmëria e këtyre auditorëve nxit studentët për t'u përfshirë në mënyrë më të drejtpërdrejtë në jetën profesionale.
12. Bashkëpunimi me aktorë të brendshëm dhe të jashtëm nga fusha të ndryshme. Këto bashkëpunime rrisin mundësitë për praktikat profesionale të studentëve dhe punësimin e tyre pas diplomimit.
13. Organizimi i ateliesë së multimedias "Media Lab", në përbërjen e së cilës është edhe redaksia e portalit informativ "Objektiv.al", e cila është në shërbim të studentëve për praktikat profesionale dhe projekte të ndryshme multimediale.
14. Biblioteka e KUB-së është një burim shumë i mirë literature si klasike ashtu dhe online ("Jstore"). Sidomos gjatë vitit të fundit, numri i botimeve që kanë të bëjnë me programet e ofruara është rritur ndjeshëm.
15. Programet ekstra-kurrikulare janë një mundësi shumë e mirë për studentët për të kuptuar dhe për të zhvilluar më mirë talentin, prijet dhe interesat e tyre dhe për t'i përdorur ato në funksion të të ardhmes së tyre.
16. Planifikimi i mirë i karrierës profesionale, i cili nis që me praktikat e gjetura dhe të organizuara nga departamenti, në bashkëpunim të ngushtë me zyrën për këshillimin e karrierës. Angazhimi i përfaqësuesit të departamentit pranë zyrës së këshillimit të karrierës përbën një avantazh për studentët.

Pika të dobëta


1. Një program i ri në Departamentin e Shkencave të Komunikimit. Fakti që programi profesional në "Multimedia dhe Dizajn Grafik", nuk ka diplomuar ende brezin e parë të studentëve çka bën që të mos ketë një network mes studentëve dhe të diplomuarve të mirësishtuar në tregun e punës.
2. Literaturë e pamjaftueshme në gjuhën shqipe (origjinale dhe e përkthyer). Ndonëse në disa raste ekzistojnë botime në gjuhën shqipe, mbetet sërish shqetësim përditësimi i tyre me zhvillimet më të fundit.
3. Mungesë njohjeje në treg si institucion që ofron programe profesionale.
4. Paragjykimi që ekziston ende, si reminishencë e së kaluarës ndaj institucioneve të arsimit të lartë jopublik.

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X

IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT DHE MBËSHTETJA E STUDENTËVE				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X





Lista e dokumentacionit mbështetës të vetëvlerësimit

- Evidenca 1: Mendimi i Dekanit
- Evidenca 2: Statuti i Kolegjit Universitar “Bedër”
- Evidenca 3: Rregullorja themelore e Kolegjit Universitar “Bedër”
- Evidenca 4: Rregullorja mbi Organizimin Administrativ
- Evidenca 5: Rregullorja e “Programit Profesional në Multimedia dhe Dizajn Grafik”
- Evidenca 6: Rregullorja e anketave dhe vlerësimeve
- Evidenca 7: Rregullorja e programeve të studimit të ciklit të parë
- Evidenca 8: Rregullorja e sekretarisë mësimore
- Evidenca 9: Vendimi i këshillit të departamentit për përcaktimin e përfaqësuesit të karrierës
- Evidenca 10: Rregullorja e transferimeve
- Evidenca 11: Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e KP për garantimin e standardeve të cilësisë
- Evidenca 12: Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC-së
- Evidenca 13: Rregullorja mbi zbritjet e tarifave të studimeve
- Evidenca 14: Buxheti i Departamentit të Shkencave të Komunikimit
- Evidenca 15: Certifikata pjesëmarrje të personelit akademik në aktivitete ndërkombëtare
- Evidenca 16: Dokument i pjesëmarrjes në Bologna Hub Peer Support
- Evidenca 17: Guida e Personelit
- Evidenca 18: Guida e Studentit
- Evidenca 19: Gjurmimi i të Diplomuarve
- Evidenca 20: Kërkesë për fillimin e procesit të vlerësimit të jashtëm të programit nga ana e Kolegjit Universitar “Bedër” drejtuar Bordit të akreditimit
- Evidenca 21: Lista e aktiviteteve dhe vizitave studimore të studentëve
- Evidenca 22: Lista e kompanive që janë vizituar nga studentët
- Evidenca 23: Lista e praktikave profesionale të studentëve
- Evidenca 24: Lista e të dhënave të dosjes së stafit
- Evidenca 25: Dosja e plotë e aplikimit për programin profesional në “Multimedia dhe Dizajn Grafik”
- Evidenca 26: Lista e trajnimeve të stafit
- Evidenca 27: Lista e të ftuarve në leksionet e hapura
- Evidenca 28: Lista IAL-ve me të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi
- Evidenca 29: Lista me CV-të e stafit
- Evidenca 30: Manuali për përgatitjen e tezës së diplomës dhe kriteret e vlerësimit të tezës për studentët e ciklit të parë
- Evidenca 31: Marrëveshja për akses në JSTOR
- Evidenca 32: Marrëveshjet e bashkëpunimit (aktive) dhe mobiliteti për staf dhe studentë me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit - Marrëveshje mobiliteti për staf dhe studentë me Aurel Vlaicu Universita of Arad, Rumani dhe College of Applied Sciences, “Lavoslav Rurilta” in Vukovar, Kroaci në kuadër të programit Erasmus+

Evidenca 33: Marrëveshjet e bashkëpunimit (aktive) me organizata, institucione dhe aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj dhe për praktikën profesionale

Evidenca 34: Plani strategjik Institucional i KU Bedër 2018-2023

Evidenca 35: Praktika e ndjekur për miratim të kriterëve të pranimit të studentëve

Evidenca 36: Praktikë ankimim note

Evidenca 37: Procedura e punësimit të personelit

Evidenca 38: Procesverbal mbledhje departamenti, ku është trajtuar një temë e sjellë nga studentet dhe ku kanë qenë prezent përfaqësues të studentëve

Evidenca 39: Procedura e vlerësimit të performancës së stafit akademik

Evidenca 40: Programi i ditëve të orientimit

Evidenca 41: Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave të Komunikimit, viti akademik 2018-2019

Evidenca 42: Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave të Komunikimit, viti akademik 2019-2020

Evidenca 43: Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave të Komunikimit, viti akademik 2020-2021

Evidenca 44: Struktura organizative e fakultetit

Evidenca 45: Studim tregu i zhvilluar nga Departamenti i Shkencave të Komunikimit mbi “Peisazhin e fushës së medias dhe komunikimit në Shqipëri”

Evidenca 46: Studim Tregu përpara hapjes së programit profesional Multimedia dhe Dizajn Grafik

Evidenca 47: Sylabuset e lëndëve

Evidenca 48: Sylabus lënda “Dizajn Grafik”

Evidenca 49: Sylabuset e lëndëve “Vizatim Kreativ” dhe “Fotografi”

Evidenca 50: Shembull - Shkresë drejtuar një kompanie për realizimin e praktikave mësimore

Evidenca 51: Anketa e posaçme realizuar në kushtet e pandemisë Covid-19

Evidenca 52: Anketa Vlerësuese nga Stafi Akademik ndaj institucionit

Evidenca 53: Anketa vlerësuese për lëndën dhe pedagogun nga studentët

Evidenca 54: Anketë vlerësimi e mendimit të studentëve ndaj institucionit

Evidenca 55: Shembull Sylabusi

Evidenca 56: Shkresa nga NJSBC te HR

Evidenca 57: Udhëzim “Për ngarkesën mësimore”

Evidenca 58: Udhëzim mbi funksionimin e bibliotekës

Evidenca 59: Udhëzim mbi mësimdhënien në distancë

Evidenca 60: Udhëzues i sistemit informativ (BIS)

Evidenca 61: Vendim i këshillit të departamentit për ngarkesën mësimore

Evidenca 62: Vendimi i këshillit të departamentit për caktimin e këshilltarëve akademik

Evidenca 63: Vendimi i senatit për përfshirjen e studentëve në këshillin e departamentit dhe në këshillat e fakulteteve

Evidenca 64: Zgjedhjet e Këshillit Studentor

ANEKS

TABELAT PËRMBLEDHËSE

- Numri i personelit akademik për çdo njësi bazë: Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat; Personeli ndihmës Akademik dhe Administrativ (PNA dhe PA) (Tabelat 1 dhe 2)

Tabela 1

Kolegji Universitar "Bedër"	Fakulteti i Shkencave Humane					
	(Viti akademik 2019 - 2020)					
	Numri i PAE		Numri i PAK		Numri i P ndihmës Akademik	Total
	Gj	Tituj/Grada	Gj	Tituj/Grada	Gj	
Departamenti i Drejtësisë	9	(1) Prof. Dr.	13	(1) Prof. Dr.	0	22
		(0) Prof. Asoc. Dr.		(1) Prof. Asoc. Dr.		
		(3) Dr.		(4) Dr.		
		(0) Dr.proc.		(0) Dr.proc.		
		(5) MSc.		(7) MSc.		
Departamenti i Shkencave të Komunikimit	11	(0) Prof. Dr.	8	(0) Prof. Dr.	1	20
		(0) Prof. Asoc. Dr.		(1) Prof. Asoc. Dr.		
		(6) Dr.		(3) Dr.		
		(1) Dr.proc.		(1) Dr.proc.		
		(4) MSc.		(3) MSc.		
Departamenti i Shkencave Islame	8	(0) Prof. Dr.	6	(0) Prof. Dr.	0	14
		(1) Prof. Asoc. Dr.		(0) Prof. Asoc. Dr.		
		(2) Dr.		(1) Dr.		
		(2) Dr.proc.		(2) Dr.proc.		
		(3) MSc.		(3) MSc.		
Në total	28		27		1	56

Kolegji Universitar "Bedër"	Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë					
	(Viti akademik 2020 - 2021)					
	Numri i PAE		Numri i PAK		Numri i P ndihmës Akademik	Total
	Gj	Tituj/Grada	Gj	Tituj/Grada	Gj	
Departamenti i Drejtësisë	12	(1) Prof. Dr.	16	(1) Prof. Dr.	0	28
		(0) Prof. Asoc. Dr.		(1) Prof. Asoc. Dr.		
		(5) Dr.		(5) Dr.		
		(0) Dr.proc.		(0) Dr.proc.		
		(6) MSc.		(9) MSc.		
Departamenti i Shkencave të Komunikimit	9	(0) Prof. Dr.	11	(0) Prof. Dr.	1	21
		(0) Prof. Asoc. Dr.		(1) Prof. Asoc. Dr.		
		(4) Dr.		(4) Dr.		

		(1) Dr.proc.		(0) Dr.proc.		
		(4) MSc.		(6) MSc.		
Departamenti i Edukimit dhe Gjuhës Angleze	7	(0) Prof. Dr.	4	(0) Prof. Dr.	0	11
		(0) Prof. Asoc. Dr.		(0) Prof. Asoc. Dr.		
		(3) Dr.		(2) Dr.		
		(1) Dr.proc.		(0) Dr.proc.		
		(3) MSc.		(2) MSc.		
Departamenti i Shkencave Islame	7	(0) Prof. Dr.	5	(0) Prof. Dr.	0	12
		(1) Prof. Asoc. Dr.		(0) Prof. Asoc. Dr.		
		(2) Dr.		(1) Dr.		
		(2) Dr.proc.		(1) Dr.proc.		
		(2) MSc.		(3) MSc.		
Në total	35		36		1	72

Kolegji Universitar "Bedër"	Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë					
	(Viti akademik 2021 - 2022)					
	Numri i PAE		Numri i PAK		Numri i P ndihmës Akademik	Total
	Gj	Tituj/Grada	Gj	Tituj/Grada	Gj	
Departamenti i Drejtësisë	10	(1) Prof. Dr.	13	(1) Prof. Dr.	0	23
		(0) Prof. Asoc. Dr.		(0) Prof. Asoc. Dr.		
		(5) Dr.		(6) Dr.		
		(0) Dr.proc.		(0) Dr.proc.		
		(4) MSc.		(6) MSc.		
Departamenti i Shkencave të Komunikimit	10	(0) Prof. Dr.	4	(0) Prof. Dr.	3	17
		(0) Prof. Asoc. Dr.		(1) Prof. Asoc. Dr.		
		(3) Dr.		(1) Dr.		
		(1) Dr.proc.		(0) Dr.proc.		
		(7) MSc.		(2) MSc.		
Departamenti i Edukimit dhe Gjuhës Angleze	8	(0) Prof. Dr.	2	(0) Prof. Dr.	1	11
		(0) Prof. Asoc. Dr.		(0) Prof. Asoc. Dr.		
		(4) Dr.		(1) Dr.		
		(1) Dr.proc.		(0) Dr.proc.		
		(3) MSc.		(1) MSc.		
Departamenti i Shkencave Islame	10	(0) Prof. Dr.	4	(0) Prof. Dr.	0	14
		(1) Prof. Asoc. Dr.		(0) Prof. Asoc. Dr.		
		(2) Dr.		(2) Dr.		
		(3) Dr.proc.		(0) Dr.proc.		
		(4) MSc.		(2) MSc.		
Në total	38		23		4	65

Tabela 2¹⁸¹

¹⁸¹ Institucioni do të plotësojë tabelat për tre vitet e fundit, për secilin Departament (nëse janë të ndryshëm).

Departamenti i Shkencave të Komunkimit						
(Viti akademik 2019 - 2020)						
Personeli Akademik Efektiv (Emër Mbiemër)	Detyra në Dep.	Titulli/Grada	Personeli Akademik me Kontratë (Emër Mbiemër)	Titulli/Grada	Institucioni ku punon full time	
1	Erlis Çela	Pergj. depart	Dr.	Mark Marku	Prof.Asoc.Dr.	Universiteti i Tiranës
2	Ardita Reçi	Lektor	Dr.	Ramadan Çipuri	Dr.	Universiteti i Tiranës
3	Ndriçim Çiroka	Lektor	Dr.	Irena Myzeqari	Dr.	Universiteti European i Tiranës
4	Valmora Gogo	Lektor	Dr.	Hasan Bello	Dr.	Akademia e Studimeve Albanologjike
5	Ana Kekezi	Lektor	Dr.	Fatos Hakorja	Msc.	Klan Tv
6	Agron Tufa	Lektor	Dr.	Mentor Kikia	Msc.	Klan Plus Tv
7	Emirjon Senja	Asistent Lektor	Msc.	Suela Tuci	Msc.	E vetpunësuar
8	Rudi Dunga	Asistent Lektor	Msc.	Anxhela Hoxha	Msc.	
9	Norga Sulo	Asistent Lektor	Msc.			
10	Edlira Mali	Asistent Lektor	Msc.			
11	Jola Marku	Asistent Lektor	Msc.			
Personeli Ndihmës Akademik (Emër Mbiemër)						
1	Alban Tufa					

Departamenti i Shkencave të Komunkimit						
(Viti akademik 2020 - 2021)						
Personeli Akademik Efektiv (Emër Mbiemër)	Detyra në Dep.	Titulli/Grada	Personeli Akademik me Kontratë (Emër Mbiemër)	Titulli/Grada	Institucioni ku punon full time	
1	Erlis Çela	Pergj. depart	Dr.	1	Mark Marku	Prof.Asoc.Dr. Universiteti i Tiranës
2	Anxhela Hoxha	Lektor	Dr.	2	Ardita Reçi	Dr. Ministria e Diasporës
3	Ana Kekezi	Lektor	Dr.	3	Hasan Bello	Dr. Akademia e Studimeve Albanologjike
4	Valmora Gogo	Lektor	Dr.	4	Ramadan Çipuri	Dr. Universiteti i Tiranës
5	Emirjon Senja	Asistent Lektor	Msc.	5	Dr. Irena Myzeqari	Dr. Universiteti European i Tiranës
6	Alban Tufa	Asistent Lektor	Msc.	6	Fatos Hakorja	Msc. Klan Tv
7	Rudi Dunga	Asistent Lektor	Msc.	7	Mentor Kikia	Msc. Klan Plus Tv
8	Edlira Mali	Asistent Lektor	Msc.	8	Ejup Lila	Msc. Komuniteti Musliman i Shqipërisë
9	Jola Marku	Asistent Lektor	Msc.	9	Soela Zani	Msc. E vetpunësuar
Personeli Ndihmës Akademik (Emër Mbiemër)			10	Silvana Xheka	Msc.	E vetpunësuar
1	Melsena Danglli			11	Suela Tuci	Msc. E vetpunësuar

Departamenti i Shkencave të Komunikimit							
(Viti akademik 2021 - 2022)							
Personeli Akademik Efektiv (Emër Mbiemër)		Detyra në Dep.	Titulli/Grada	Personeli Akademik me Kontratë (Emër Mbiemër)		Titulli/Grada	Institucioni ku punon full time
1	Erlis Çela	Pergj. depart	Dr.	1	Mark Marku	Prof.Asoc.Dr	Universiteti i Tiranës
2	Brikena Smajli	Lektor	Dr.	2	Anxhela Hoxha	Dr.	
3	Valmora Gogo	Lektor	Dr.	3	Mentor Kikia	Msc.	Universiteti i Tiranës
4	Suela Musta	Lektor	Dr.	4	Silvana Xheka	Msc.	E vetpunësuar
5	Emirjon Senja	Asistent Lektor	Msc.				
6	Alban Tufa	Asistent Lektor	Msc.				
7	Rudi Dunga	Asistent Lektor	Msc.				
8	Edlira Mali	Asistent Lektor	Msc.				
9	Norga Sulo	Asistent Lektor	Msc.				
10	Eriet Muçollari	Asistent Lektor	Msc.				
11	Ejup Lila	Asistent Lektor	Msc.				
Personeli Ndihmës Akademik (Emër Mbiemër)							
1	Melsena Danglli						
2	Bora Hasmadhi						
3	Esmeralda Pashollari						

Të dhëna Tabelore për numrin e programeve në ciklin e I-rë, të II-të dhe të III-të të studimeve, që ofrohen në Njësinë përgjegjëse (Tabela 3)

Tabela 3

Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë	(Viti akademik 2021-.2022)						Total
	Numri i programeve profesionalë jouniversitarë	Numri i programeve BSc	Numri i programeve MSc	Numri i programeve MP	Numri i programeve MSc (Integruar)	Numri i programeve e Dr	
Departamenti i Edukimit dhe Gjuhës Angleze	-	1	1	1	-	-	3
Departamenti i Drejtësisë	-	1	1	-	1	-	3
Departamenti i Shkencave Islame	-	1	2	-	-	-	3
Departamenti i Shkencave të Komunikimit	1	2	1	1	-	-	5
Në total	1	5	5	2	1	-	14

Ngarkesa totale e personelit akademik të Departamentit të Shkencave të Komunikimit në një vit akademik (Tabela 4)

Tabela 4

Viti akademik aktual ¹⁸²										
Nr	Titulli/grada Emr Mbiemër	Lënda/ët	Ngarkesa mësimore (orë) në Bsc Shkenca Komunikim i	Ngarkesa mësimore (orë) në Bsc Marredhenie Publike dhe Komunikim Marketingu	Ngarkesa mësimore (orë) në Program Profesional Multimedia dhe Dizajn Grafik	Ngarkesa mësimore (orë) në Master i Shkencave ne shkenca komunikimi, profili Marredhenie me Publikun/Gazeta ri	Ngarkesa mësimore (orë) në Master i Profesional ne Komunikim Marketingu	Ngarkesa mësimore (orë) në program e të tjera (orë) në Total	Tot ali	Stat usi PAE apo PAK
			Orë mësimore	Orë mësimore	Orë mësimore	Orë mësimore	Orë mësimore	Orë mësimore		
1	Dr. Erlis Çela	Edukimi mbi median dhe informacionin	3	3					26	PAE
		Marrëdhënie Publike	3	3						
		Media Sociale			1					
		Aplikacionet Multimediale					2			
		Reklama dhe Promocioni				3	4			
		Mediat e Reja		3	2					
		Teoritë e Komunikimit	3	3						
		Agjencitë e Lajmeve	1							
		Punimi i diplomës		4						
		Teza				4	2			
2	Dr. Valmora Gogo	Hyrje në Komunikim Masiv	3		3				27	PAE
		Filozofi Komunikimi	3	3						
		Etika e Medias dhe Legjislacioni		1						
		Konceptim dhe Menaxhim Fushatash				1				
		Publiku, Audiencia dhe Përdoruesit e Mediave				3				
		Audienca		3	3					
		Metodat e Redaktimit	3							
		Shtypi i Shkruar dhe	3							

¹⁸² Në rastin kur stafi akademik zhvillon të njëjtën lëndë në disa programe në të njëjtin orar (pra bashkohen klasat) orët do deklarohen vetëm një herë

		Online								
		Komunikim Biznesi		3						
		Media dhe Etika				3				
		Teza				4	2			
3	Dr.Brikena Smajli	Hyrje në Analizë Ligjërimi	3							
		Mendimi Estetik dhe Marrëdhënia me Artin dhe Ligjërimin				3				
		Teoritë e Përkthimit				3				
		Teoritë e Përkthimit				2	2			
		Historia e Videos dhe Kinemasë			4					
		E Folura në Publik	1							
		Punimi i diplomës		4						
		Audienca	3							
		Praktikë profesionale				2				
4	Dr.Ndriçim Çiroka	Marketingu dhe Marrëdhëniet Publike Online		3						3 PAE
5	Dr.Ana Kekezi	Marketing Mediatik				1				
		Konceptim dhe Menaxhim Fushatash					1			
		Marketingu dhe Marrëdhëniet Publike Online		3	3					
		Marketingu Politik-Mjetet, Teknikat dhe Strategjitë					3			20 PAE
		Komunikim Politik	3							
		Menaxhimi i Marrëdhënieve me Klientin		3						

		Komunikim politik		6							
		Metodat e Avancuara Kërkimore II					1				
		Komunikimi dhe Menaxhimi i Markës dhe Identitetit Institucional					1				
		Strategjia dhe Menaxhimi i Markës						2			
		Marketing Dixhital						2			
		Teza					2	2			
6	Dr.Suela Musta	Strategji Kreativiteti						1	20	PAE	
		Komunikim Vizual		3	3						
		Metodat e Avancuara Kërkimore I						1			
		Identitetet dhe Komunikimi Masiv					3				
		Praktike Profesionale			2						
		Marrëdhënia e Lajmit, Pushtetit dhe të Vërtetës					3				
		Mediat e Reja	1								
		Punimi i Diplomës	3								
		Epoka dhe Rrymat Ndërkulturore					4				
7	Msc. Emirjon Senja	Gazetari Ekonomike	6						6	PAE	
		Intervistimi									
8	Msc.Edlira Mali	Konceptim dhe Menaxhim Fushatash				3	3		39	PAE	
		Marketing Strategjik		4							
		Praktikë profesionale		3							
		Marketing					3				

		Mediatik									
		Strategji Kreativiteti					3				
		Strategji Kreativiteti			3						
		Bazat e Marketingut		3							
		Statistikë për Shkencat Sociale	2	2							
		Punimi i Diplomës	3								
		Reklama dhe Promocioni		4							
		Menaxhim i markës		4							
		Komunikimi dhe Menaxhimi i Markës dhe Identitetit Institucional				2					
		Strategjia dhe Menaxhimi i Markës					2				
9	Msc.Rudi Dunga	Shkrim dhe Raportim Lajmi I	5								
		Punimi i Diplomës/ Provim përfundimtar			3						
		Praktikë profesionale	3								19 PAE
		Shkrim dhe Raportim Lajmi II	3								
		Agjencitë e Lajmeve	2								
		Punimi i Diplomës	3								
10	Msc.Alban Tufa	Metodat e kërkimit & Shkrimi Akademik	3	3							
		Praktikë profesionale	3								26 PAE
		Bazat e Semiotikës	1	1							
		Multimedia		3	3						

		Mediat e Reja	2							
		Editim Audio dhe Video			2					
		Aplikacionet Multimediale					3			
		E Folura në Publik	2							
		Punimi i Diplomës	3							
		Audienat		1						
11	Msc.Norga Sulo	Marketing Mediatik	3						9	PAE
		Praktikë profesionale		3						
		Statistikë për Shkencat Sociale	1	1						
		Bazat e Marketingut			2					
12	Msc.Eriet Mucollari	Fotografi Kreative			3				10	PAE
		Animacion			2					
		Dizajn Multimedial			2					
		Vizatim Kreativ			3					
13	Msc.Erilda Ajaz	Komunikimi Organizativ	3						6	PAE
		Metodat e Avancuara Kërkimore I				3				
		Metodat e Avancuara Kërkimore II				3				
14	Msc.Ejup Lila	Dizajn Grafik I			2				11	PAE
		Dizajn Grafik II			2					
		Media Sociale				2				
		Dizajni i Reklamave			2					
15	Prof. Asoc. Dr.Mark Marku	Media dhe Politika				3			9	PAK
		Historia e Medias	3		3					

16	Dr.Anxhela Hoxha	Teknikat e Shkrimit në Komunikimin e Integruar		4	3				15	PAK
		Teknikë Filmi dhe Regjie			3					
		Strategji kreativiteti		4						
		Praktikë Profesionale					2			
		Teza					2			
17	Msc.Mentor Kikia	Etika e Medias dhe Legjislacioni		3					3	PAK
